

**RREGULLORJA E KOMISIONIT (EU) 2017/459 e 16 marsit 2017 për krijimin e një kodi të rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit dhe shfuqizimin e Rregullores (BE) Nr. 984/2013**

versioni i përshtatur sipas Nenit 24 të Traktatit të Komunitetit të Energjisë për miratim nga Grupi i Përhershëm i Nivelit të Lartë

**KREU I**

**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

*Neni 1*

**Qëllimi**

Kjo Rregullore krijon një kod të rrjetit që vendos mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit për kapacitetet ekzistuese dhe në rritje. Kjo rregullore përcakton se si bashkëpunojnë operatorët e sistemit të transmetimit, në mënyrë që të lehtësojnë shitjet e kapaciteteve, duke pasur parasysh rregullat e përgjithshme komerciale si dhe teknike lidhur me mekanizmat e alokimit të kapaciteteve.

*Neni 2*

**Fusha e Veprimit**

- 1.Kjo rregullore zbatohet për pikat e interkonjeksionit midis Palëve Kontraktore. Pikat hyrëse dhe dalje të Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian dhe pikat e hyrjes dhe dalje në vende të treta mund të konsiderohen pikat e interkonjeksionit për qëllimet e kësaj Rregullore, sipas vendimit të autoritetit kombëtar rregullator përkatës. Kjo Rregullore nuk zbatohet për pikat e dalje në konsumatorët fundorë dhe rrjetet e shpërndarjes, pikat e hyrjes nga terminalët e termocentralit të lëngëzuar të gazit natyror (LNG) dhe objektet gjeneruese, si dhe pikat e hyrjes ose dalje në objektet e depozitimit.
- 2.Mekanizmat e standardizuar të alokimit të kapaciteteve të krijuara në përputhje me këtë Rregullore do të përfshijnë një procedurë ankandë për pikat relevante të interkonjeksionit brenda Komunitetit të Energjisë dhe produktet standarde të kapacitetit që do të ofrohen dhe alokohen. Aty ku ofrohet kapacitet rritës, mund të përdoren edhe mekanizmat alternativë të alokimit, sipas kushteve të përcaktuara në Nenin 30 (2).
- 3.Kjo rregullore zbatohet për të gjitha kapacitetet teknike dhe të ndërprerë në pikat e interkonjeksionit, si dhe për kapacitetin e shtesë në kuptim të pikës 2.2.1 të Aneksit I të Rregullores (KE) Nr 715/2009 dhe kapacitetit rritës.

4. Kur zbatohet një mekanizëm alternativ i alokimit të kapaciteteve sipas Nenit 30, Nenet 8 (1) deri në (7), Nenet 11 deri 18, Neni 19 (2) dhe Neni 37 nuk do të zbatohen në nivelet e ofertave, përveç nëse vendoset ndryshe nga autoritetet kombëtare rregullatore përkatëse.

5. Aty ku nënkuptohet aplikimi i metodave të alokimit të kapacitetit, autoritetet kombëtare rregullatore mund të vendosin të mos zbatojnë Nenet 8 deri në 37.

6. Për të parandaluar mbylljen e tregut të distribucionit, autoritetet kombëtare rregullatore, pas konsultimit me përdoruesit e rrjetit, mund të vendosin të marrin masa proporcionale për të kufizuar oferten paraprake për kapacitet nga çdo përdorues i vetëm i rrjetit në pikat e interkonjeksionit brenda territorit të një pale Kontraktore.

### *Neni 3*

#### **Përkufizimet**

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, Neni 2 i Rregullores (KE) Nr 715/2009, Neni 3 dhe Neni 24 i Rregullores së Komisionit (BE) 2017/460 dhe Neni 2 Direktiva 2009/73 / EC do të zbatohen. Përveç kësaj, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. **“kapaciteti rritës”** do të thotë rritje e mundshme në të ardhmen e kapacitetit teknik ose kapaciteti i ri i krijuar aty ku ai nuk egziston i cili krijohet duke ndjekur procedura të bazuara në kërkesat e tregut. Ky kapacitet mund të ofrohet duke u bazuar në investime, në infrastrukturë fizike apo optimizim afatgjatë të kapaciteteve, dhe më tej mund t’i ofrohet tregut pas rezultatit pozitiv të një testi ekonomik, në rastet si vijon:
  - a. në pikat ekzistuese të interkonjeksionit;
  - b. duke krijuar një pikë ose pika të reja të interkonjeksionit;
  - c. si kapacitet fizik të rrjedhjes së kundërt në një pike ose pika interkonektimi, e cila nuk është ofruar më parë;
2. **“pika e interkonjeksionit”** nënkupton një pikë fizike ose virtuale që lidh sistemet hyrëse-dalëse ngjitur ose që lidh një sistem hyrje-dalje me një interkonektor, përderisa këto pika i nënshtrohen procedurave të rezervimit nga përdoruesit e rrjetit;
3. **“mekanizmi alternativ i alokimit”** do të thotë një mekanizëm alokimi për nivelin e ofertës ose kapacitetin rritës të hartuar rast pas rasti nga operatorët e sistemit të transmetimit dhe të miratuar nga autoritetet kombëtare rregullatore, për të akomoduar nevojat e kushtëzuara të kërkesës;
4. **“produkti i kapacitetit standard”** nënkupton një sasi të caktuar të kapacitetit të transportit gjatë një periudhe të caktuar kohore, në një pikë të specifikuar të interkonjeksionit;
5. **“niveli i ofertës”** do të thotë shuma e kapacitetit në dispozicion dhe niveli përkatës i kapacitetit rritës të ofruar për secilin nga produktet vjetore të kapacitetit standard në një pikë interkonjeksioni;

6. **“metoda implicite e alokimit”** nënkupton një metodë të alokimit të kapacitetit, ku, ndoshta me anë të një ankandi, edhe kapacitetet transmetuese edhe një sasi përkatëse të gazit ndahen në të njëjtën kohë;
7. **“raundi i ofertimit”** do të thotë periudha kohore gjatë së cilës përdoruesit e rrjetit mund të paraqesin, ndryshojnë dhe tërheqin ofertat;
8. **“hapi i çmimit të madh (*large price step*)”** nënkupton një sasi fikse ose të ndryshueshme që është përcaktuar për pikën e interkonjeksionit dhe produktin e kapacitetit standard;
9. **“projekti për rritjen e kapacitetit”** do të thotë një projekt për të rritur sasinë e kapacitetit teknik në një pikë ekzistuese të interkonjeksionit ose për të krijuar një pikë të re të interkonjeksionit bazuar në alokimin e kapaciteteve në procesin e mëparshëm të kapacitetit rritës;
10. **“test ekonomik”** nënkupton një test të zbatuar për të vlerësuar qëndrueshmërinë ekonomike të projekteve të kapaciteteve në rritje;
11. **“procesi i kapacitetit rritës”** do të thotë një proces për të vlerësuar kërkesën e tregut për kapacitet në rritje që përfshin një fazë jo detyruese (*non-binding*), në të cilën përdoruesit e rrjetit shprehin dhe caktojnë kërkesën e tyre për kapacitet në rritje dhe një fazë detyruese, në të cilën kërkojnë angazhime të detyrueshme për kapacitetin kontraktues nga përdoruesit e rrjetit nga një ose më shumë operatorë të sistemit të transmetimit;
12. **“kapaciteti i lidhur (*bundled*)”** nënkupton një produkt të kapacitetit standard i garantuar i ofruar që përbëhet nga kapaciteti përkatës i hyrjes dhe daljes në të dy anët e çdo pike të interkonjeksionit;
13. **“marrëveshja e interkonjeksionit”** nënkupton një marrëveshje të lidhur nga operatorët e sistemit të transmetimit kufitare sistemet e të cilave janë të lidhura në një pikë të veçantë interkonjeksioni, e cila specifikon termat dhe kushtet, procedurat operative dhe dispozitat, në lidhje me lëvrimin dhe / ose tërheqjen e gazit në pikën e interkonjeksionit me qëllim lehtësimin e ndërveprimit efikas të rrjeteve të transmetimit të ndërlidhur, siç përcaktohet në Kreun II të Rregullores (BE) 2015/703;
14. **“kapacitetet konkurruese”** do të thotë kapacitetet për të cilat kapaciteti në dispozicion në një pikë të rrjetit nuk mund të ndahet pa e reduktuar plotësisht ose pjesërisht kapacitetin në dispozicion në një pikë tjetër të rrjetit;
15. **“kalendari i ankandit”** do të thotë një tabelë që shfaq informacione në lidhje me ankandet specifike të cilat publikohen nga ENTSOG çdo vit kalendarik për ankandet që zhvillohen gjatë periudhës mars deri në shkurt të vitit të ardhshëm kalendarik dhe që përbëhen nga të gjitha afatet përkatëse për ankand, duke përfshirë datat e fillimit dhe produktet standarde të kapacitetit për të cilat ato adresohen;
16. **“dita e gazit”** do të thotë periudha nga ora 5.00 deri në 5.00 UTC e ditës tjetër për kohën e dimrit dhe nga 4.00 deri 4.00 UTC e ditës tjetër kur zbatohet kursimi i ditës;
17. **“kapaciteti brenda ditës”** do të thotë kapaciteti i ofruar dhe alokuar pas mbylljes së ankandeve të kapaciteteve të ditës së ardhshme në lidhje me atë ditë;
18. **“ankand i çmimit në rritje (*ascending clock auction*)”** -do të thotë një ankand në të cilin një përdorues i rrjetit vendos sasi të kërkuara kundrejt hapave të përcaktuar të çmimeve, të cilat shpallen në vijimësi;

19. **“ankand me çmime të uniformizuara”** nënkupton një ankand në të cilin përdoruesi i rrjetit në një raund të vetëm të ofertimit të çmimeve ofron si çmimin dhe sasinë, dhe të gjithë përdoruesit e rrjetit, të cilët janë të suksesshëm në fitimin e kapacitetit, paguajnë çmimin e ofertës më të ulët të suksesshme;
20. **“çmimi i rezervimit”** - do të thotë çmimi minimal i kualifikuar (floor price) në ankand;
21. **“hapi i çmimit të vogël (small price step)”** nënkupton një sasi fikse ose të ndryshueshme që përcaktohet për pikë të interkonjeksionit dhe produkt të kapacitetit standard që është më i vogël se hapi i çmimit të madh;
22. **“kerkesa me e ulet se oferta (first-time undersell)”** nënkupton një dukuri ku kërkesa agregate për të gjithë përdoruesit e rrjetit është më e vogël se kapaciteti i ofruar në fund të raundit të dytë të ofertimit ose në një raund tjetër të ofertimit;
23. **“pika virtuale e interkonjeksionit”** nënkupton dy ose më shumë pika të interkonjeksionit që lidhin dy sistemet hyrëse-dalje kufitare, të integruara së bashku për qëllime të ofrimit të një shërbimi të vetëm kapaciteti;
24. **“f-faktor”** - nënkupton pjesën e vlerës aktuale të rritjes së parashikuar në të ardhurat e lejuara ose të synuara të operatorit të sistemit të transmetimit i lidhur me kapacitetin rritës të përfshirë në nivelin e ofertës përkatëse siç përcaktohet në Nenin 22 (1) (b) të mbulohet nga vlera aktuale e angazhimeve të detyrueshme të përdoruesve të rrjetit për kapacitetin kontraktues të llogaritur siç përcaktohet në Nenin 22 (1) (a);
25. **“mbi-nominim”** nënkupton të drejtën e përdoruesve të rrjetit që përmbushin kërkesat minimale për dorëzimin e nominimeve për të kërkuar kapacitet të ndërprerë në çdo kohë brenda ditës duke paraqitur një nominim që e rrit totalin e nominimeve të tyre në një nivel më të lartë se kapaciteti i tyre i kontraktuar.
26. **“konsumatorët e mbrojtur”** do të thotë të gjithë konsumatorët shtëpiak që janë të lidhur me rrjetin e shpërndarjes së gazit dhe, përveç kësaj, kur Pala Kontraktore në fjalë vendos, gjithashtu mund të nënkuptojë një ose më shumë nga këto, me kusht që ndërmarrjet ose shërbimet sipas pikave (a) dhe (b) nuk përfaqësojnë më së shumti 20% të konsumit të përgjithshëm vjetor të gazit në atë të Palës Kontraktore:
  - a. ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, me kusht që ato të jenë të lidhura me rrjetin e shpërndarjes së gazit; b) një shërbim social thelbësor, me kusht që ajo të jetë e lidhur me një rrjet shpërndarjeje ose transmetimi të gazit;
  - b. një instalim të ngrohjes qendrore në masën që ajo furnizon ngrohje për konsumatorët familjarë, ndërmarrjet e vogla ose të mesme ose shërbime të domosdoshme sociale, me kusht që instalimi i tillë të mos jetë në gjendje të kalojë në lëndë djegëse të tjera përveçse gazit.

## KREU II

### PARIMET E BASHKEPUNIMIT

#### *Neni 4*

#### **Koordinimi i mirëmbajtjes**

Kur mirëmbajtja e një tubacioni ose një pjese të një rrjeti të transmetimit ndikon në sasinë e kapacitetit transmetues që mund të ofrohet në pikat e interkonjeksionit, operatori i sistemit të transmetimit do të bashkëpunojë plotësisht me operatorin/ët e afërt të sistemit/eve të transmetimit në lidhje me planet e mirëmbajtjes për të minimizuar ndikimin në rrjedhat e mundshme të gazit dhe kapacitetin në një pikë interkonektimi.

#### *Neni 5*

### **Standardizimi i komunikimit**

1. Operatorët e sistemit të transmetimit duhet të koordinojnë zbatimin e procedurave standarde të komunikimit, sistemet e koordinuara të informacionit dhe komunikimeve elektronike të përshtatshme në internet, të tilla si formatet dhe protokollet e përbashkëta të shkëmbimit të të dhënave, si dhe pajtohen parimet se si trajtohen këto të dhëna.
2. Procedurat standarde të komunikimit përfshijnë, në veçanti, ato që kanë të bëjnë me aksesin e përdoruesve në sistemin e ankandit të operatorëve të sistemit të transmetimit ose një platformë përkatëse rezervimi dhe shqyrtimin e informacionit të ofruar në ankand. Koha dhe përmbajtja e të dhënave që duhet të shkëmbehet duhet të jenë në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Kreun III.
3. Procedurat standarde të komunikimit të miratuara nga operatorët e sistemeve të transmetimit përfshijnë një plan zbatimi dhe kohëzgjatjen e zbatueshmërisë, i cili duhet të jetë në përputhje me zhvillimin e platformës së rezervimeve siç përcaktohet në Nenin 37. Operatorët e sistemeve të transmetimit do të sigurojnë konfidencialitetin e informacionit komercialisht të ndjeshëm.

#### *Neni 6*

### **Llogaritja e kapaciteteve dhe maksimizimi**

1. Kapaciteti maksimal teknik duhet të vihet në dispozicion për përdoruesit e rrjetit, duke marrë parasysh integritetin e sistemit, sigurinë dhe funksionimin efikas të rrjetit.
  - a. Për të maksimizuar ofertën e kapacitetit të lidhur nëpërmjet optimizimit të kapacitetit teknik, operatorët e sistemit të transmetimit duhet të marrin masat e mëposhtme në pikat e interkonjeksionit, duke u dhënë përparësi atyre pikave të interkonjeksionit, kur ka konxhension kontraktual sipas pikës 2.2.3 (1) të Shtojcës I në Rregulloren (KE) No.715/2009: operatorët e sistemit të transmetimit përcaktojnë dhe zbatojnë një metodë të përbashkët, ku përcaktohen hapat e veçantë që duhet të ndërmerren nga operatorët përkatës të sistemit të transmetimit për të arritur optimizimin e kërkuar:
    1. metoda e përbashkët do të përfshijë një analizë të thellë të kapaciteteve teknike, duke përfshirë çdo mospërputhje në to në të dy anët e një pike të interkonjeksionit, si dhe

veprimet specifike dhe orarin e detajuar - përfshirë implikimet e mundshme dhe që përmbajnë miratimet rregullatore të kërkuara për të mbuluar kostot dhe të përshtatet regjimi rregullator - i nevojshëm për të maksimizuar ofertën e kapacitetit të lidhur. Veprimet e tilla specifike nuk do të dëmtojnë ofertën e kapaciteteve në pikat e tjera relevante të sistemeve përkatëse dhe i referohen rrjeteve shpërndarëse të rëndësishme për sigurinë e furnizimit për konsumatorët fundorë, siç janë ato për sistemet e depozitimit, terminalët e LNG dhe konsumatorët e mbrojtur;

- 2.metodologjia e llogaritjes dhe rregullat e vënies në dispozicion të kapacitetit, të miratuara nga operatorët e sistemit të transmetimit, adresojnë situata specifike ku kapacitetet konkurruese në gjithë sistemet përfshijnë pikat e interkonjeksionit dhe pikat e daljes në sistemet e depozitimit;
- 3.kjo analizë e thelluar do të marrë në konsideratë supozimet e bëra në planin 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit aty ku është e aplikueshme, planet kombëtare të investimeve, obligimet përkatëse sipas ligjeve të zbatueshme kombëtare dhe çdo detyrimi kontraktual përkatës;
- 4.operatorët përkatës të sistemit të transmetimit duhet të zbatojnë një qasje dinamike për ri-llogaritjen e kapacitetit teknik, kur është e përshtatshme, në lidhje me llogaritjen dinamike të aplikuar për kapacitet shtesë në bazë të pikës 2.2.2.2 të Aneksit I të Rregullores (KE) Nr 715/2009, duke identifikuar së bashku frekuencën e duhur për ri-llogaritjen për pikë interkonjeksioni dhe duke pasur parasysh specifikat e veçanta të tyre;
- 5.në metodën e përbashkët, operatorët e sistemit të transmetimit fqinjë do të konsultojnë operatorë të tjerë të sistemit të transmetimit të prekur në mënyrë specifike nga pika e interkonjeksionit;
- 6.operatorët e sistemit të transmetimit duhet të kenë parasysh informacionin që përdoruesit e rrjetit mund të ofrojnë në lidhje me flukset e pritshme të ardhshme kur të ri-llogarisin kapacitetin teknik.

b.operatorët e sistemit të transmetimit duhet së bashku të vlerësojnë të paktën parametrat e mëposhtëm dhe sipas nevojës t'i përshtatin ato:

- 1.angazhimet sipas presionit;
- 2.të gjithë skenarët relevantë të kërkesës dhe furnizimit, duke përfshirë detajet mbi kushtet klimatike referuese dhe konfigurimet e rrjetit të lidhura me skenarë ekstremë;
- 3.vlera kalorifike.

2.Kur optimizimi i kapacitetit teknik shkakton kosto për operatorët e sistemit të transmetimit, sidomos kostot që ndikojnë në mënyrë të pabarabartë operatorët e sistemit të transmetimit në secilën anë të një pike interkonjeksioni, operatorët e sistemit të transmetimit lejohen të rikuperojnë kostot e tilla në mënyrë efikase nëpërmjet kuadrit rregullator të përcaktuar nga autoritetet rregullatore në përputhje me Nenin 13 të Rregullores (KE) Nr 715/2009 dhe Nenin 42 të Direktivës 2009/73 / EC.

2a. Për infrastrukturën ndërkufitare, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do të vendosë mbi ato çështje rregullatore që janë kompetencë e autoriteteve kombëtare rregullatore:

- a. ku autoritetet rregullatore kombëtare kompetente nuk kanë qenë në gjendje të arrijnë një marrëveshje brenda një periudhe gjashtë mujore nga data kur rasti i është referuar për here të fundit autoriteteve rregullatore; ose
- b. me kërkesë të përbashkët nga autoritetet rregullatore kombëtare kompetente.

Autoritetet rregullatore kombëtare kompetente mund të kërkojnë bashkërisht që periudha e përmendur në pikën (a) të zgjatet për një periudhë deri në gjashtë muaj.

Gjatë përgatitjes së vendimit, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do të konsultohet me autoritetet kombëtare rregullatore dhe operatorët e sistemit të transmetimit dhe do të informohet për propozimet dhe vëzhgimet e të gjithë operatorëve të sistemit të transmetimit në fjalë.

Kur një rast i është referuar Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë sipas paragrafit 2a, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë:

- a) do të sigurojë vendimin e tij brenda një periudhe prej 6 muajsh nga dita e referimit; dhe
- b) do të mundet nëse është e nevojshme, të sigurojë një vendim të përkohshëm për të siguruar që siguria e furnizimit ose siguria operative e infrastrukturës në fjalë është e mbrojtur.

3. Aty ku është e përshtatshme, autoritetet kombëtare rregullatore do të konsultojnë përdoruesit e rrjetit mbi metodën e llogaritjes së aplikuar dhe qasjen e përbashkët.

4. Ndryshimet në sasinë e kapacitetit të ofruar në pikat e interkonjeksionit si rezultat i procesit sipas paragrafit 1 do të përfshihen në raportin e Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë të publikuar në përputhje me pikën 2.2.1 (2) të Aneksit I të Rregullores (EC) Nr 715/2009.

#### *Neni 7*

#### **Shkëmbimi i informacionit ndërmjet operatorëve të sistemit të transmetimit fqinje**

1. Operatorët e sistemit të transmetimit afër do të shkëmbejnë rregullisht nominimin, ri-nominimin, përputhjen dhe konfirmimin e informacionit në pikat relevante të interkonjeksionit në mënyrë periodike.
2. Operatorët e sistemit të transmetimit në afërsi do të shkëmbejnë informacion rreth mirëmbajtjes së rrjetit të tyre individual të transmetimit me qëllim që të kontribuojnë në procesin e vendimmarrjes në lidhje me përdorimin teknik të pikave të interkonjeksionit. Procedurat për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet operatorëve të sistemit të transmetimit duhet të integrohen në marrëveshjen përkatëse të interkonjeksionit.

## KREU 3

### ALOKIMI I PRODUKTEVE TE KAPACITETIT TE GARANTUAR

#### Neni 8

#### Metodologjia e alokimit

1. Ankandet do të përdoren për alokimin e kapaciteteve në pikat e interkonjeksionit, përveç rasteve kur zbatohet metodologjia alternative e alokimit sipas Nenit 30.
2. Në të gjitha pikat e interkonjeksionit aplikohet projektimi i njëjtë i ankandit. Proceset relevante të ankandit duhet të fillojnë njëkohësisht për të gjitha pikat e interkonjeksionit përkatës. Çdo proces ankandi, që lidhet me një produkt me kapacitet të vetëm standard, duhet të alokojë kapacitetin në mënyrë të pavarur nga çdo proces tjetër i ankandit, përveç kur ofrohet kapacitet shtesë ose kur, sipas marrëveshjes së operatorëve të sistemit të transmetimit të përfshirë drejtpërdrejtë dhe miratimit të autoriteteve përkatëse kombëtare rregullatore, alokohet kapaciteti konkurrues. Autoriteti kombëtar rregullator i çdo Pale Kontraktore ose Shtet Anëtar të afërt dhe të prekur mund të sigurojë një pozicion që do të konsiderohet nga autoriteti përkatës kombëtar rregullator. Në rast të ofrimit të kapacitetit rritës, alokimi i pavarur nuk zbatohet për proceset e njëkohshme të ankandit për nivelin e ofertës përkatëse, pasi këto janë të varura nga njëra-tjetra, mund të ndahet si vetëm një nivel oferte.
3. Produktet e kapacitetit standard do të ndjekin një rend logjik me të cilin do të ofrohen së pari produktet që mbulojnë kapacitetin vjetor, dhe pastaj produkti me kohëzgjatjen më të shkurtër të afërt për përdorim gjatë së njëjtës periudhë. Koha e ankandeve të parashikuara në Nenet 11 deri në 15 duhet të jetë në përputhje me këtë parim.
4. Rregullat për produktet e kapacitetit standard të përcaktuara në Nenin 9 dhe ankandet e përcaktuara në Nenet 11 deri 15 do të zbatohen për kapacitetin e lidhur dhe kapacitetin e ndare (*unbundled*) në një pikë interkonjeksioni.
5. Për një ankand të caktuar, disponueshmëria e produkteve përkatëse të kapacitetit standard do të komunikohet në përputhje me Nenet 11 deri 15 dhe sipas kalendarit të ankandit.
6. Një shumë të paktën e barabartë me 20% të kapacitetit ekzistues teknik në secilën pikë të interkonjeksionit duhet të lihet mënjane dhe ofrohet në përputhje me paragrafin 7. Nëse kapaciteti në dispozicion është më pak se sa proporcioni i kapacitetit teknik të lënë mënjane, i gjithë kapaciteti në dispozicion do të lihet mënjane. Ky kapacitet do të ofrohet në përputhje me pikën (b) të paragrafit 7, ndërsa çdo kapacitet i mbetur i lënë mënjane do të ofrohet në përputhje me pikën (a) të paragrafit 7.
7. Çdo kapacitet i lënë mënjane sipas paragrafit 6 do të ofrohet, në përputhje me dispozitat e mëposhtme:



- a. një shumë minimale e barabartë me 10% të kapacitetit teknik ekzistues në secilën pikë të interkonjeksionit do të ofrohet jo më herët se në ankandin e kapacitetit vjetor, siç parashikohet në Nenin 11 të mbajtur në përputhje me kalendarin e ankandit gjatë vitit të pestë të gazit para fillimit të vitit përkatës të gazit; dhe
  - b. një sasi tjetër, të paktën e barabartë me 10% të kapacitetit ekzistues teknik në secilën pikë interkonjeksioni, së pari do të ofrohet jo më herët se ankandi vjetor i kapaciteteve tremujore, siç parashikohet në Nenin 12, të mbajtur në përputhje me kalendarin e ankandit gjatë vitit të gazit që i parapriu fillimi i vitit përkatës të gazit.
8. Në rastin e kapacitetit rritës, një shumë të paktën e barabartë me 10% të kapacitetit teknik në rritje në pikën përkatëse të interkonjeksionit do të mënjanohet dhe ofrohet jo më herët se ankandi vjetor i kapaciteteve tremujore, siç parashikohet në Nenin 12, të mbajtur në përputhje me kalendarin e ankandit gjatë vitit të gazit para fillimit të vitit relevant të gazit.
  9. Përqindja e saktë e kapacitetit që duhet lënë mënjane në pajtim me paragrafët 6 dhe 8 do të jetë subjekt i një konsultimi të palëve të interesuara, rënia dakord ndërmjet operatorëve të sistemit të transmetimit dhe miratimit nga autoritetet kombëtare rregullatore në secilën pikë të interkonjeksionit. Autoritetet kombëtare rregullatore në veçanti do të konsiderojnë vendosjen mënjane të aksioneve më të larta të kapacitetit me një kohëzgjatje më të shkurtër për të shmangur mbylljen e parakohshme të tregut të shpërndarjes.
  10. Kapaciteti i krijuar nëpërmjet procedurave që nuk janë bazuar në treg dhe për të cilat është marrë vendimi përfundimtar i investimit pa angazhime paraprake nga përdoruesit e rrjetit, duhet të ofrohet dhe alokohen si produkte të kapacitetit standard të disponueshëm siç përcaktohet në këtë Rregullore.

#### *Neni 9*

#### **Produkte të kapacitetit standard**

1. Operatorët e sistemit të transmetimit ofrojnë produkte të kapacitetit standard vjetore, tremujore, mujore, ditore dhe brenda ditës.
2. Produktet vjetore të kapacitetit standard do të jetë kapaciteti që mund të aplikohet në një sasi të caktuar nga një përdorues i rrjetit për të gjitha ditët e gazit në një vit të veçantë të gazit (duke filluar nga 1 tetori).
3. Produktet e kapacitetit standard tremujor do të jetë kapaciteti që mund të aplikohet në një sasi të caktuar nga një përdorues i rrjetit për të gjitha ditët e gazit në një tremujor të caktuar (duke filluar më 1 tetor, 1 janar, 1 prill ose 1 korrik respektivisht).

4. Produktet e kapaciteteve standarde mujore do të jetë kapaciteti që mund të aplikohet në një sasi të caktuar nga një përdorues rrjeti për të gjitha ditët e gazit në një muaj të veçantë kalendarik (duke filluar nga dita e parë e çdo muaji).
5. Produktet e kapaciteteve standarde të përditshme do të jetë kapaciteti i cili mund të aplikohet në një sasi të caktuar nga një përdorues rrjeti për një ditë të vetme të gazit.
6. Produktet e kapaciteteve standarde brenda ditës do të jetë kapaciteti i cili mund të aplikohet në një sasi të caktuar nga një përdorues rrjeti nga një kohë fillestare brenda një dite të gazit të veçantë deri në fund të së njëjtës ditë të gazit.

#### *Neni 10*

### **Njësia e aplikuar e kapacitetit**

Kapaciteti i ofruar do të shprehet në njësi të energjisë për njësi të kohës. Do të përdoren njësitë e mëposhtme: kWh / h ose kWh / d. Në rastin e kWh / d do supozohet një normë rrjedhëse e sheshtë gjatë ditës së gazit.

#### *Neni 11*

### **Ankandet vjetore të kapacitetit**

1. Ankandi i kapaciteteve vjetore do të mbahet një herë në vit.
2. Kapaciteti për çdo produkt vjetor të kapacitetit standard do të hidhet në ankand përmes ankandit vjetor të kapacitetit duke përdorur algoritmin e ankandit të çmimit në rritje në përputhje me Nenin 17.
3. Procesi i ankandit do të ofrojë kapacitet të paktën për 5 vitet e ardhshme të gazit dhe jo më shumë se 15 vitet e ardhshme të gazit për kapacitetin ekzistues. Kur ofrohet kapacitet rritës, nivelet e ofertave mund të ofrohen në ankand të kapaciteteve vjetore për një maksimum 15 vjet pas fillimit të përdorimit operacional.
4. Që nga viti 2020, ankandet vjetore të kapacitetit vjetor fillojnë nga e hëna e parë e korrikut çdo vit, përveç nëse specifikohet ndryshe në kalendarin e ankandit.
5. Gjatë përdorimit vjetor të rrjetit të ankandit të kapacitetit përdoruesit duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në një ose disa ankande në lidhje me secilën pikë interkonjeksioni, në mënyrë që të aplikojnë për produkte të kapacitetit standard.
6. Kapaciteti që do të ofrohet gjatë ankandit vjetor të kapacitetit vjetor është i barabartë me:

$$A - B - C + D + E - F$$

Ku:

**A** është kapaciteti teknik i operatorit të sistemit të transmetimit për secilin nga produktet e kapacitetit standard;

**B** për ankandet vjetore të përvitshme që ofrojnë kapacitet për 5 vitet e ardhshme, është sasia e kapacitetit teknik (A) të caktuar në pajtim me Nenin 8 (7); për ankandet vjetore të përvitshme për kapacitet përtej 5 viteve të para, është sasia e kapacitetit teknik (A) të caktuar në përputhje me Nenin 8 (7);

**C** është kapaciteti teknik i shitur më parë, i axhustuar nga kapaciteti i cili ri-ofrohet në përputhje me procedurat e zbatueshme të menaxhimit të kongjestionit;

**D** është kapacitet shtesë, për një vit të tillë, nëse ka;

**E** është kapaciteti rritës për një vit të tillë të përfshirë në nivelin përkatës të ofertës, nëse ka;

**F** është shuma e kapacitetit rritës (E), nëse ka, të lënë mënjanë në përputhje me Nenin 8 (8) dhe (9).

7. Kapaciteti që do të ofrohet mund të jetë ose kapacitet i lidhur ose kapaciteti i ndare në përputhje me Nenin 19. Kjo vlen edhe për të gjitha ankandet e tjera të përcaktuara në Nenet 12 deri në 15.

8. Së paku 1 muaj para fillimit të ankandit, operatorët e sistemit të transmetimit duhet të njoftojnë përdoruesit e rrjetit për sasinë e kapacitetit të garantuar që do të ofrohet për çdo vit për ankandin e ardhshëm vjetor të kapacitetit.

9. Raundet e ofertave të secilit ankand do të zhvillohen në orën 8.00 UTC deri në 17.00 UTC (koha e dimrit) ose nga ora 7.00 UTC deri në orën 16.00 UTC (ora dimërore) për të gjitha ditët përkatëse të gazit. Raundet e ofertave duhet të hapen dhe të mbyllen brenda çdo dite të gazit, siç përcaktohet në Nenin 17 (2).

10. Rezultatet e alokimit të ankandit do të vihen në dispozicion, sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se dita e ardhshme e punës pas mbylljes së raundit të ofertimit, në të njëjtën kohë për përdoruesit individual të rrjetit që marrin pjesë në ankandin përkatës.

Në rast të kapacitetit në rritje, angazhimet e detyrueshme të përdoruesve të rrjetit për kapacitetin e kontraktuar, duke përfshirë nëse kushtet për një ankand të përsëritur sipas Nenit 29 (3) janë plotësuar, duhet të vihen në dispozicion jo më vonë se ditën tjetër të punës pas mbylljes së raundit të ofertave, njëkohësisht për përdoruesit e rrjetit individual që marrin pjesë në ankandin përkatës. Rezultatet e testeve ekonomike duhet të vihen në dispozicion jo më vonë se 2 ditë pune pas mbylljes së raundit të ofertave, njëkohësisht për përdoruesit individual të rrjetit që marrin pjesë në ankandin përkatës.

11. Informacioni i grumbulluar për rezultatet e ankandit duhet të publikohet në treg.

*Neni 12*

### **Ankandet vjetore për kapacitete tremujore**

1. Katër ankande tremujore vjetore të kapaciteteve do të mbahen gjatë çdo viti gazi.
2. Kapaciteti për secilin produkt tremujor të kapacitetit standard do të vihet në ankand përmes ankandit tremujor vjetor të kapaciteteve duke përdorur algoritmin e ankandit të çmimit në rritje, në përputhje me Nenin 17.
3. Kapaciteti për tremujorët e vitit të ardhshëm të gazit do të vihen në ankand nëpërmjet ankandëve konkurrues për çdo tremujor dhe në lidhje me secilën pikë të interkonjeksionit si vijon:
  - a. për tremujorin e parë (tetor-dhjetor) deri në të katërtin (korrik-shtator) në ankandin e parë tremujor të kapaciteteve vjetore;
  - b. për tremujorin e dytë (janar-mars) deri në katër (korrik-shtator) në ankandin e dytë tremujor të kapacitetit vjetor;
  - c. për tremujorin e tretë (janar-mars) deri në katër (korrik-shtator) në ankandin e tretë tremujor të kapacitetit vjetor;
  - d. për tremujorin e fundit (korrik-shtator) në ankandin e katërt tremujor të kapacitetit tremujor
4. Çdo vit i gazit ankandi tremujor vjetor i kapaciteteve fillon në ditët në vijim, përveç nëse specifikohet ndryshe në kalendarin e ankandit:
  - a. ankandi i parë tremujor vjetor i kapaciteteve fillon të hënën e parë të muajit gusht;
  - b. ankandi i dytë tremujor i kapaciteteve fillon të hënën e parë të nëntorit;
  - c. ankandi i tretë tremujor i kapaciteteve fillon të hënën e parë të shkurtit;
  - d. ankandi i katërt tremujor i kapaciteteve fillon të hënën e parë të muajit maj.
5. Kapaciteti që do të ofrohet në të gjitha ankandet tremujore të kapaciteteve do të jetë e barabartë me:

$$A - C + D$$

Ku:

**A** është kapaciteti teknik i operatorit të sistemit të transmetimit për secilin nga produktet e kapacitetit standard;

**C** është kapaciteti teknik i shitur më parë, i rregulluar nga kapaciteti i cili ri-ofrohet në përputhje me procedurat e zbatueshme të menaxhimit të kongjestionit;

**D** është kapacitet shtesë, për një tremujor të tillë, nëse ka.

6. Dy javë përpara fillimit të ankandëve, operatorët e sistemit të transmetimit duhet të njoftojnë përdoruesit e rrjetit për sasinë e kapacitetit që do të ofrohet për secilin tremujor për ankandin e ardhshëm tremujor të kapacitetit.
7. Raundet e ofertave të secilit ankand, do të zhvillohen në orën 8.00 UTC deri në 17.00 UTC (koha e dimrit) ose 7.00 UTC deri në 16.00 UTC (ora dimërore) për të gjitha ditët përkatëse të

gazit. Raundet e ofertave duhet të hapen dhe të mbyllen brenda çdo dite të gazit, siç përcaktohet në Nenin 17 (2).

8. Rezultatet e alokimit të ankandit do të publikohen, sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se ditën e ardhshme të punës pas mbylljes së raundit të ofertave, njëkohësisht për përdoruesit individual të rrjetit që marrin pjesë në ankandin përkatës.
9. Informacioni i grumbulluar për rezultatet e ankandit do të publikohet në treg.

### *Neni 13*

#### **Ankandet mujore të kapaciteteve (*rolling monthly auctions*)**

1. Ankandi mujor i kapacitetit do të mbahet një herë në muaj.
2. Kapaciteti për secilin product mujor të kapacitetit standard do të vihet në ankand përmes ankandit mujor të kapacitetit të linjës duke përdorur algoritmin e ankandit të çmimit në rritje, sipas nenit 17. Çdo muaj, produkti mujor i kapacitetit të standardit për muajin vijues kalendarik do të bëhet në ankand.
3. Gjatë zhvillimit të ankandit mujor të kapacitetit, përdoruesit e rrjetit duhet të jenë në gjendje të aplikojnë për një produkt mujor të kapacitetit standard.
4. Ankandet mujor të kapacitetit do të fillojnë në të hënën e tretë të çdo muaji për produktin e ardhshëm mujor të kapacitetit standard, përveç nëse specifikohen ndryshe në kalendarin e ankandit.
5. Kapaciteti që do të ofrohet në ankandin mujor të kapacitetit do të jetë çdo muaj i barabartë me:

$$A - C + D$$

Ku:

**A** është kapaciteti teknik i operatorit të sistemit të transmetimit për secilin nga produktet e kapacitetit standard;

**C** është kapaciteti teknik i shitur më parë, i rregulluar nga kapaciteti i cili ri-ofrohet në përputhje me procedurat e aplikueshme të menaxhimit të kongestionit;

**D** është kapacitetet shtesë, për një muaj të tillë, nëse ka.

6. Një javë para fillimit të ankandit, operatorët e sistemit të transmetimit do të njoftojnë përdoruesit e rrjetit për sasinë e kapacitetit që do të ofrohet për ankandin e ardhshëm mujor të kapacitetit.

7. Raundet e ofertave të secilit ankand do të zhvillohen në orën 8.00 UTC deri në 17.00 UTC (koha e dimrit) ose nga ora 7.00 UTC deri në orën 16.00 UTC (ora dimerore) për të gjitha ditët gazit. Raundet e ofertave duhet të hapen dhe të mbyllën brenda çdo dite të gazit, siç përcaktohet në Nenin 17 (2).
8. Rezultatet e alokimit të ankandit do të publikohen, sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se ditën e ardhshme të punës pas mbylljes së raundit të ofertave, njëkohësisht për përdoruesit individual të rrjetit që marrin pjesë në ankandin përkatës.
9. Informacioni i grumbulluar për rezultatet e ankandit do të publikohet në treg.

#### *Neni 14*

#### **Ankandet e kapaciteteve i ditës në avancë**

1. Ankandi i kapacitetit i ditës në avancë do të mbahet një herë në ditë.
2. Çdo ditë, një produkt i kapacitetit standard për ditën e ardhshme të gazit do të vihet në ankand përmes ankandit të kapacitetit të ditës në avancë.
3. Kapaciteti për çdo produkt të kapacitetit standard ditor do të bëhet në ankand nëpërmjet ankandit të kapacitetit të ditës në avancë duke përdorur një algoritëm ankandi të çmimeve uniforme sipas Nenit 18. Çdo ditë, produkti ditor i kapacitetit standard për ditën e nesërme të gazit do të bëhet në ankand.
4. Gjatë përdorimit të rrjetit të ankandit për ditën e ardhshme, përdoruesit e rrjetit duhet të jenë në gjendje të aplikojnë për kapacitet standard ditor.
5. Raundi i ofertave do të hapet çdo ditë në ora 15:30 UTC (ora e dimrit) ose 14:30 UTC (ora dimërore)
6. Një ofertë e kapacitetit për produktin ditor të kapacitetit standard për ankandin e kapacitetit të ditor do të trajtohet si më poshtë: dorëzimi, tërheqja ose ndryshimi nga ora 15.30 UTC deri në orën 16.00 UTC (ora dimërore) ose 14.30 UTC deri në orën 15.00 UTC (ora dimërore).
7. Kapaciteti që do të ofrohet në ankandin e kapacitetit të ditës në avancë do të jetë, çdo ditë, i barabartë me:

$$A - C + D$$

Ku:

A është kapaciteti teknik i operatorit të sistemit të transmetimit për secilin nga produktet e kapacitetit standard;

**C** është kapaciteti teknik i shitur më parë, i rregulluar nga kapaciteti i cili ri-ofrohet në përputhje me procedurat e aplikueshme të menaxhimit të kongestionit;

**D** është kapacitetet shtesë, për një ditë të tillë, nëse ka.

8. Në kohën kur hapet raundi i ofertave, operatorët e sistemit të transmetimit do të njoftojnë përdoruesit e rrjetit për sasinë e kapacitetit që do të ofrohet për ankandin e kapacitetit të ditës në avancë.
9. Rezultatet e alokuara të ankandit do të publikohen, jo më vonë se 30 minuta pas mbylljes së raundit të ofertave, në të njëjtën kohë tek përdoruesit individual të rrjetit që marrin pjesë në ankandin përkatës.
10. Informacioni i grumbulluar për rezultatet e ankandit do të publikohet në treg.

### *Neni 15*

#### **Ankandet brenda ditës të kapaciteteve**

1. Me kusht që kapaciteti të vihet në dispozicion, një ankand brenda ditës do të mbahet çdo orë gjatë ditës së gazit duke përdorur një algoritëm të çmimeve uniforme në ankand, në përputhje me nenin 18.
2. Raundi i parë i ofertave do të hapet drejtpërsëdrejti në orën e ardhshme pas botimit të rezultateve të ankandit të fundit të ditës në avancë (përfshirë kapacitetin e ndërprerë nëse ofrohet) në pajtim me Nenin 14. Raundi i parë i ofertave mbyllet në 1.30 UTC (ora dimërore) ose 0.30 UTC (ora dimërore) para ditës së gazit. Alokimi i ofertave të suksesshme do të jetë në fuqi nga ora 5.00 UTC (ora e dimrit) ose 4.00 UTC (ora dimërore) në ditën përkatëse të gazit.
3. Raundi i fundit i ofertave do të mbyllet në orën 0.30 UTC (ora dimërore) ose 23.30 UTC (ora dimërore) në ditën përkatëse të gazit.
4. Përdoruesit e rrjetit do të kenë të drejtë të vendosin, tërheqin apo ndryshojnë ofertat nga hapja e çdo raundi të ofertimit deri në mbylljen e atij raundi të ofertimit.
5. Çdo orë në ditën përkatëse të gazit, kapaciteti i efektshëm nga ora + 4 do të bëhet në ankand si kapacitet brenda ditës.
6. Çdo raund oferta duhet të hapet në fillim të çdo ore në ditën përkatëse të gazit.
7. Kohëzgjatja e çdo raundi oferte do të jetë 30 minuta nga hapja e raundit të ofertimit.
8. Kapaciteti që do të ofrohet në ankandin e kapacitetit brenda ditës do të jetë, çdo orë, i barabartë me:

## A - C + D

Ku:

**A** është kapaciteti teknik i operatorit të sistemit të transmetimit për secilin nga produktet e kapacitetit standard;

**C** është kapaciteti teknik i shitur më parë, i rregulluar nga kapaciteti i cili ri-ofrohet në përputhje me procedurat e aplikueshme të menaxhimit të kongestionit;

**D** është kapacitetet shtesë, nëse ka.

9. Operatorët e sistemit të transmetimit do të publikojnë sasinë e disponueshme të kapacitetit brenda ditës që është në ofertë, pas mbylljes së ankandit të fundit të ditës në avancë dhe në përputhje me Nenin 32 (9).
10. Operatorët e sistemit të transmetimit do t'u sigurojnë përdoruesve të rrjetit të cilët ofrojnë në ankandet e ditës në avancë oferta të vlefshme të pasuksesshme, të futen automatikisht në ankandin pasues brenda ditës.
11. Kapaciteti do të alokohet brenda 30 minutave nga mbyllja e raundit të ofertave me kusht që ofertat të pranohen dhe operatori i sistemit të transmetimit të kryejë procesin e alokimit.
12. Rezultatet e ankandit do të bëhen të disponueshme njëkohësisht për përdoruesit individual të rrjetit.
13. Informacioni i grumbulluar për rezultatet e ankandit do të publikohet së paku në fund të çdo dite.

## *Neni 16*

### **Algoritmi i ankandit**

1. Nëse ofrohen disa produkte të kapacitetit standard gjatë një ankandi, algoritmi përkatës i alokimit do të zbatohet veçmas për çdo produkt të kapacitetit standard kur të jetë alokuar. Ofertat për produkte të ndryshme të kapacitetit standard do të konsiderohen të pavarura nga njëri-tjetri në zbatimin e algoritmit të ankandit.
2. Për ankandet vjetore, tremujore dhe mujore të kapacitetit, do të zbatohet një algoritëm i ankandit të çmimit në rritje, me runde të shumta të ofertimit, siç parashikohet në Nenin 17.
3. Për ankandet e kapacitetit të ditës në avancë dhe ankandet e kapaciteteve brenda ditës, një algoritëm me ankande me çmime uniforme, me një raund të vetëm oferte do të zbatohet në përputhje me Nenin 18.



## Neni 17

### Algoritmi e ankandit të çmimit ne rritje

1. Ankandet e çmimit në rritje duhet t'u mundësojnë përdoruesve të rrjetit të vendosin oferta vëllimi kundrejt çmimeve të shkallëzuara të shpallura në raundin e ofertës së radhës, duke filluar nga çmimi rezervë  $P_0$ .
2. Raundi i parë i ofertimit, me një çmim të barabartë me çmimin e rezervimit  $P_0$ , duhet të ketë një kohëzgjatje prej 3 orësh. Raundet e ofertimit të mëvonshëm do të kenë një kohëzgjatje prej 1 ore. Do të ketë një periudhë prej 1 ore ndërmjet raundeve të ofertimit.
3. Një ofertë duhet të specifikojë:
  - a. identitetin e përdoruesit të rrjetit që aplikon;
  - b. pika përkatëse e interkonjeksionit dhe drejtimi i rrjedhës;
  - c. produkti standard i kapacitetit për të cilin aplikohet kapaciteti;
  - d. çmimet për çdo hap, sasinë e kapacitetit për produktin përkatës të kapacitetit standard të aplikuar;
  - e. ku ofrohet kapacitet rritës, niveli i ofertës në fjalë.
4. Një ofertë do të konsiderohet e vlefshme nëse paraqitet nga një përdorues rrjeti dhe është në përputhje me të gjitha dispozitat e këtij neni.
5. Në mënyrë që përdoruesit e rrjetit të marrin pjesë në një ankand, do të jetë e detyrueshme për përdoruesit e rrjetit që të vendosin një ofertë sasiore në raundin e parë të ofertave.
6. Operatorët e sistemit të transmetimit u ofrojnë përdoruesve të rrjetit mundësinë për të hyrë automatikisht në oferta, kundrejt çdo hapi të çmimeve.
7. Pasi mbyllet raundi përkatës i ofertave, nuk do të pranohet modifikimi, tërheqja ose ndryshimi i ofertave të vlefshme. Të gjitha ofertat e vlefshme do të bëhen angazhime detyruese të një përdoruesi të rrjetit për të ruajtur kapacitetin në shumën e kërkuar për çmimin e shpallur, me kusht që çmimi i ekuilibër (*clearing price*) i ankandit është ai që shpallet në raundin përkatës të ofertimit.
8. Oferta e sasisë në çdo raund të ofertës për përdorues të rrjetit duhet të jetë e barabartë ose më e vogël me kapacitetin e ofruar në një ankand të veçantë. Oferta e sasisë për përdoruesit e rrjetit me një çmim të caktuar do të jetë e barabartë ose më e vogël se oferta e volumit e vendosur nga ky përdorues i rrjetit në raundin e mëparshëm, përveç rasteve kur zbatohet paragrafi 16.
9. Ofertat mund të dorëzohen, modifikohen dhe tërhiqen lirisht gjatë një raundi oferte, duke siguruar që të gjitha ofertat janë në përputhje me paragrafin 8. Ofertat e vlefshme do të mbeten të vlefshme derisa të modifikohen ose të tërhiqen.

10. Hapi i çmimit të madh dhe hapi i çmimit të vogël duhet të përcaktohen për pikë interkonektive dhe për produktin e kapacitetit standard dhe duhet të publikohen përpara ankandit përkatës. Hapi i çmimit të vogël duhet të vendoset në mënyrë të tillë që një rritje me një numër të plotë të hapave të çmimeve të vogla është e barabartë me një rritje të një hapi të çmimeve të mëdha.
11. Përcaktimi i hapit të çmimit të madh do të kërkojë të minimizojë, deri në sa të jetë e mundur, kohëzgjatjen e procesit të ankandit. Përcaktimi i hapit të çmimit të vogël do të kërkojë të minimizojë, sa të jetë e mundur, nivelin e kapacitetit të pashpallur kur ankandi mbyllet me një çmim më të lartë se çmimi i rezervimit.
12. Nëse kërkesa agregate për të gjithë përdoruesit e rrjetit është më e vogël ose e barabartë me kapacitetin e ofruar në fund të raundit të parë të ofertimit, ankandi do të mbyllet.
13. Nëse kërkesa agregate për të gjithë përdoruesit e rrjetit është më e madhe se kapaciteti i ofruar në fund të raundit të parë të ofertimit ose në një raund tjetër të ofertimit, një raund tjetër i ofertave do të hapet me një çmim të barabartë me çmimin në raundin e mëparshëm të ofertimit, plus hapin e çmimit të madh.
14. Nëse kërkesa agregate për të gjithë përdoruesit e rrjetit është e barabartë me kapacitetin e ofruar në fund të raundit të dytë të ofertimit ose në një raund tjetër të ofertimit, ankandi do të mbyllet.
15. Nëse ndodh një fenomen i kërkesës më të ulët se oferta, do të bëhet një ulje e çmimeve dhe do të hapet një raund tjetër i ofertimit. Raundi i mëtejshëm i ofertave do të ketë një çmim të barabartë me çmimin e aplikueshëm në raundin e ofertës, në momentin e kërkesës më të ulët se oferta, plus hapin e çmimit të vogël. Do të hapen raunde të tjera të ofertave me hapa të çmimeve të vogla derisa kërkesa agregate për të gjithë përdoruesit e rrjetit të jetë më e vogël ose e barabartë me kapacitetin e ofruar, në çastin kur ankandi do të mbyllet.
16. Oferta e sasisë për përdoruesit e rrjetit në të gjitha raundet e ofertimit ku zbatohen hapa të çmimeve të vogla do të jetë e barabartë ose më e vogël se oferta e sasisë e vendosur nga ky përdorues i rrjetit në raundin e ofertimit, në kohën e kërkesës më të ulët se oferta. Oferta e sasisë për përdoruesin e rrjetit për një hap të caktuar të çmimit të vogël duhet të jetë i barabartë ose më i vogël se oferta e sasisë e vendosur nga ky përdorues i rrjetit në raundin e mëparshëm të ofertave të hapave të çmimeve të vogla. Oferta e sasisë për përdoruesit e rrjetit në të gjitha raundet e ofertimit ku zbatohen hapa të vogla të çmimeve do të jetë e barabartë ose më e madhe se oferta e sasisë e vendosur nga ky përdorues i rrjetit gjatë raundit të ofertimit në të cilin ndodhi në kohën e kërkesës më të ulët se oferta.
17. Nëse kërkesa agregate për të gjithë përdoruesit e rrjetit është më e madhe se kapaciteti i ofruar në raundin e ofertave me një çmim të barabartë me atë që rezultoi në kohën e kërkesës më të ulët se oferta, minus një hap të çmimit të vogël, ankandi do të mbyllet. Çmimi ekuilibër do të jetë çmimi që ka rezultuar në kohën e kërkesës më të ulët se oferta dhe ofertat e suksesshme do të jenë ato të dorëzuara gjatë raundit të ofertimit fillestar në të cilin ndodhi në kohën e kërkesës më të ulët se oferta.

18. Pas çdo raundi oferte, kërkesa e të gjithë përdoruesve të rrjetit në një ankand specifik do të publikohet sa më shpejt të jetë e mundur në një formë të përmbledhur.
19. Çmimi i shpallur për raundin e fundit të ofertës në të cilin mbyllet ankandi do të konsiderohet si çmimi ekuilibër i ankandit specifik, përveç rasteve kur zbatohet paragrafi 17.
20. Të gjithë përdoruesit e rrjetit të cilët kanë dhene oferta të vlefshme sasiore në çmimin ekuilibër do të shpërndahen në kapacitetin sipas ofertës së sasise të tyre në çmimin e ekuilibër. Kur ofrohet kapaciteti rritës, alokimi i kapacitetit rritës i nënshtrohet rezultatit të testit ekonomik sipas Nenit 22. Përdoruesit e suksesshëm të rrjetit paguajnë çmimin ekuilibër të ankandit specifik, i cili mund të jetë një metodë fikse ose variabel e çmimeve të pagueshme të përcaktuara në Nenin 24 të Rregullores (BE) 2017/460, dhe çdo detyrim tjetër të mundshëm të zbatueshëm në kohën kur mund të përdoret kapaciteti i alokuar për ta.
21. Pas çdo ankandi të mbyllur, publikohet rezultati përfundimtar i ankandit, duke përfshirë edhe grumbullimin e kapaciteteve të alokuara dhe çmimin ekuilibër. Përdoruesit e suksesshëm të rrjetit duhet të informohen për sasinë e kapaciteteve që ata i ndajnë, informacioni individual duhet t'u komunikohen vetëm palëve të interesuara. Kur shpërndahet kapaciteti rritës, ky paragraf zbatohet vetëm për rezultatet e ankandit të nivelit të ofertës që ofron sasinë më të madhe të kapacitetit që ka rezultuar në një test pozitiv ekonomik sipas Nenit 22 (3).
22. Nëse një ankand i çmimit ne rritje nuk ka përfunduar me pikën e planifikuar të nisjes (sipas kalendarit të ankandit) të ankandit të ardhshëm për kapacitetin që mbulon të njëjtën periudhë, ankandi i parë do të mbyllet dhe asnjë kapacitet nuk do të ndahet. Kapaciteti do të ofrohet në ankandin tjetër përkatës.

## **Neni 18**

### **Algoritmi i ankandit me çmime uniforme**

1. Në një ankand me çmime uniforme, ekziston një raund i vetëm i ofertimit, në të cilin përdoruesi i rrjetit oferton çmimin si dhe sasinë.
2. Gjatë raundit të tenderimit të një ankandi të caktuar, përdoruesit e rrjetit mund të dorëzojnë deri në 10 oferta. Çdo ofertë do të trajtohet në mënyrë të pavarur nga ofertat e tjera. Pas mbylljes së raundit të ofertave, ofertat e mbetura nuk mund të modifikohen ose të tërhiqen.
3. Një ofertë duhet të specifikojë:
  - a. identitetin e përdoruesit të rrjetit që aplikon;
  - b. pika përkatëse e interkonjeksionit dhe drejtimi i rrjedhës;
  - c. produkti standard i kapacitetit për të cilin aplikohet;
  - d. sasinë e kapacitetit për produktin përkatës të kapacitetit standard të aplikuar, i cili është i barabartë ose më i vogël se kapaciteti i ofruar në një ankand specifik;
  - e. shuma minimale e kapacitetit për produktin përkatës të kapacitetit standard të cilin përdoruesi i rrjetit është i gatshëm të ndajë sipas algoritmit përkatës në rast se shfrytëzuesi i rrjetit nuk është alokuar shuma e kërkuar është në përputhje me pikën (d);

- f. çmimet e ofertës, të cilat nuk duhet të jenë më të ulëta se çmimi rezervë i aplikueshëm për produktin përkatës të kapacitetit standard, të cilin përdoruesi i rrjetit është i gatshëm të paguajë në lidhje me kapacitetin e kërkuar. Ofertat me një çmim ofertimi nën çmimin e rezervimit nuk do të pranohen.
4. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të rendisë të gjitha ofertat që kanë të bëjnë me një produkt të kapacitetit standard të dhënë sipas çmimit të ofertës, çmimi më i lartë i vendoset i parë.
5. Të gjitha ofertat e mbetura në kohën e mbylljes së ofertimit do të konsiderohen si të detyrueshme për ata përdorues të rrjetit që kanë ndarë të paktën sasinë minimale të kapacitetit të kërkuar në përputhje me pikën (e) të paragrafit 3.
6. Pas renditjes së ofertave në pajtim me paragrafin 4, dhe në pajtim me paragrafët 7 deri në 10, kapaciteti i alokohet ofertave në funksion të rankimit të tyre të çmimeve. Të gjitha ofertat për të cilat është alokuar kapaciteti do të konsiderohen si të suksesshme. Pas shpërndarjes së kapacitetit, kapaciteti i mbetur i pakontestuar do të reduktohet nga një sasi e tillë.
7. Pas zbatimit të paragrafit 6 dhe sipas paragrafit 9, kur shuma e ofertës për kapacitet nga një përdorues i rrjetit e tejkalon kapacitetin e mbetur të pa alokuar (pasi kapaciteti është alokuar për përdoruesit e rrjetit që vendosin oferta më të larta), ketij përdorues të rrjetit do t'i alokohet kapaciteti në mënyrë të barabartë në kapacitetin e mbetur të pa alokuar.
8. Pas zbatimit të paragrafit 7 dhe në pajtim me paragrafin 9, kur secila nga dy ose më shumë ofertat specifikon të njëjtin çmim të ofertës dhe shuma e kapacitetit përkatës që mbetet në total sipas ofertave të tilla tejkalon shumën e mbetur të pa alokuar, shuma e mbetur e pa alokuar do të ndahet proporcionalisht me shumën e aplikuar në secilën ofertë të tillë.
9. Kur shuma që duhet alokuar në lidhje me një ofertë sipas paragrafëve 6, 7 ose 8 është më e vogël se shuma minimale e kapacitetit sipas pikës (e) të paragrafit 3, oferta do të konsiderohet e pasuksesshme dhe një alokim i rishikuar do të bëhet ndërmjet ofertave të barabarta të çmimit të mbetur sipas paragrafit 8, ose do të bëhet një alokim në lidhje me çmimin e ofertës së ardhshme, në përputhje me paragrafin 6.
10. Kur shuma e mbetur që do të alokohet në lidhje me çdo ofertë në përputhje me paragrafët 6, 7, 8 ose 9 është e barabartë me zero, nuk do të alokohen kapacitete të tjera për ofertat e mbetura. Këto oferta do të konsiderohen të pasuksesshme.
11. Çmimi ekuilibër do të definohet si çmimi i ofertës më të ulët të suksesshme, nëse kërkesa tejkalon ofertën me çmim rezervimi. Në të gjitha rastet e tjera, çmimi ekuilibër do të jetë i barabartë me çmimin e rezervimit. Përdoruesit e suksesshëm të rrjetit duhet të paguajnë çmimin ekuilibër të ankandit specifik, i cili mund të jetë një qasje fikse ose e ndryshueshme e çmimeve të pagueshme siç përcaktohet në Nenin 24 të Rregullores (BE) 2017/460 dhe çdo detyrim tjetër të aplikueshëm në kohën kur kapaciteti i alokuar për ta mund të përdoret.

## KREU IV

### LIDHJA E KAPACITETEVE NE PIKAT INTERKONEKTIVE

#### *Neni 19*

#### **Produktet me kapacitet te lidhur**

Operatorët e sistemit të transmetimit fqinje do të ofrojnë bashkë kapacitete të lidhura të produkteve, sipas parimeve të mëposhtme:

1. në të dy anët e një pike interkonjeksioni, të gjitha kapacitetet e garantuara do të ofrohen si një kapacitet i lidhur, për aq sa ky kapacitet është i disponueshëm dhe i qëndrueshëm ose në rritje në të dy anët e pikës së interkonjeksionit;
2. operatorët e sistemit të transmetimit do të ofrojnë kapacitet për produktin e kapacitetit standard përkatës në një platformë rezervimi, në përputhje me Nenin 37 dhe në përputhje me procedurën e alokimit të aplikueshme, siç përcaktohet në Kreun III;
3. kapaciteti i lidhur që do të ofrohet nga operatorët e sistemit të transmetimit në fjalë në një pikë interkonjeksioni do të kontraktohet nëpërmjet një procedure të vetme alokimi;
4. përdoruesit e rrjetit duhet të jenë në pajtueshmëri me kushtet dhe afatet e zbatueshme të kontratave të transportit të operatorëve të sistemit të transmetimit, që nga momenti kur nënshkruhet kontrata e kapacitetit të transportit;
5. atehere kur ka më shumë kapacitete të disponueshme të garantuara në një anë të një pike të interkonjeksionit sesa në anën tjetër për çdo periudhë të konsideruar, operatori i sistemit të transmetimit me kapacitetin më të disponueshëm të garantuar mund të ofrojë një kapacitet të tillë shtesë për përdoruesit e rrjetit si një produkt i ndarë në përputhje me kalendarin e ankandit dhe rregullat e mëposhtme:
  - (a) aty ku ekziston një kontratë ekzistuese e veçuar e transportit në anën tjetër të pikës së interkonjeksionit, kapaciteti mund të ofrohet i ndare, duke mos tejkaluar sasinë dhe kohëzgjatjen e kontratës ekzistuese të transportit në anën tjetër;
  - (b) kur një kapaciteti i tillë shtesë nuk përfshihet në pikën (a) të paragrafit 5, mund të ofrohet për një periudhë maksimale prej 1 viti;
6. çdo kapacitet i lidhur i alokuar në përputhje me paragrafin 5 mund të përdoret dhe të emërohet si i tillë. Gjithashtu mund të tregtohet në tregun sekondar;
7. operatorët e sistemit të transmetimit fqinje do të krijojnë një procedurë të përbashkët nominimi për kapacitetin e lidhur duke u ofruar përdoruesve të rrjetit mjetet për të emëruar rrjedhat e kapacitetit të tyre të lidhur nëpërmjet një nominimi të vetëm;
8. detyrimet për të ofruar kapacitete të lidhur gjithashtu zbatohen, në masën që ato janë të përshtatshme, në tregjet e mesme të kapaciteteve. Pa paragjykim për paragrafin 1, kapaciteti i alokuar fillimisht si kapacitet i lidhur mund të rishitet vetëm si kapacitet i lidhur në tregun sekondar;
9. aty ku dy ose më shumë pika të interkonjeksionit lidhin të dyja sistemet e bashkuara të hyrje-daljes, operatorët e sistemit të transmetimit fqinje duhet të ofrojnë kapacitetet e disponueshme

në pikat e interkonjeksionit në një pikë virtuale të interkonjeksionit. Në rast se janë përfshirë më shumë se dy operatorë të sistemit të transmetimit, sepse kapaciteti në një ose të dy sistemet hyrëse-dalëse tregtohet nga më shumë se një operator i sistemit të transmetimit, pika virtuale e interkonjeksionit do të përfshijë të gjithë këta operatorë të sistemit të transmetimit, për aq sa është e mundur. Në të gjitha rastet, një pikë virtuale interkonjeksioni do të krijohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- (a) kapaciteti i përgjithshëm teknik në pikat virtuale të interkonjeksionit është i barabartë ose më i lartë se shumica e kapaciteteve teknike në secilën nga pikat e interkonjeksionit që kontribuojnë në pikat virtuale të interkonjeksionit;
- (b) ato lehtësojnë përdorimin ekonomik dhe efikas të sistemit duke përfshirë por jo kufizuar në rregullat e përcaktuara në Nenin 16 të Rregullores (KE) Nr 715/2009.

Operatorët e sistemit të transmetimit fqinje do të fillojnë analizat e nevojshme dhe do të krijojnë pikat virtuale funksionale të ndërlidhjes jo më vonë se 1 nëntori 2021.

#### *Neni 20*

### **Përafrimi i afateve dhe kushteve për produktet e kapacitetit të lidhur**

Operatorët e sistemit të transmetimit, në varësi të miratimit të autoritetit kombëtar rregullator, mund të aplikojnë termat dhe kushtet e përcaktuara në skicën e publikuar në faqen e internetit të ENTSOG duke përfshirë dispozita kontraktuale të cilat nuk preken nga dallimet themelore në parimet e ligjit kombëtar ose legjisllacionit, për ofrimin e produkteve të kapacitetit të lidhur në rastin e produkteve të kapacitetit të lidhur me kontratë të re.

#### *Neni 21*

### **Lidhja e kapacitetit në rastin e kontratave ekzistuese të transportit**

1. Përdoruesit e rrjetit, të cilët janë palë në kontratat e transportit të ndarea në pikat përkatëse të interkonjeksionit, synojnë të arrijnë një marrëveshje mbi lidhjen e kapacitetit nëpërmjet marrëveshjeve kontraktuale ('marrëveshja e lidhjes), në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Nenin 19. Këto përdorues rrjeti dhe operatorët e sistemit të transmetimit raportojnë tek autoritetet përkatëse kombëtare rregullatore të gjitha marrëveshjet e lidhjes së kontratave ekzistuese të transportit.
2. Operatorët e sistemit të transmetimit të cilët janë palë në kontratat ekzistuese të transportit mund të marrin pjesë në diskutimet lidhur me marrëveshjen e lidhjes në çdo kohë, me ftesë të përdoruesve të rrjetit që janë palë në kontratat ekzistuese të transportit.
3. Nëntë muaj pas skadimit të afatit për transpozimin e kësaj rregulloreje, operatorët e sistemit të transmetimit duhet t'u ofrojnë përdoruesve të rrjetit që kanë kapacitet të ndare të pakompensuar në njërin anë të një pike interkonjektive një shërbim të konvertimit të kapacitetit pa pagesë. Një shërbim i tillë i konvertimit të kapacitetit do të zbatohet për produktet vjetore, tremujore ose mujore të kapacitetit për kapacitetin e lidhur të garantuar në atë pikë interkonjeksioni që përdoruesi i rrjetit duhet të merrte për shkak se kapaciteti i pamjaftueshëm i alokuar në anën tjetër të pikës së interkonjeksionit ishte ofruar nga një operator i sistemit të transmetimit kufitar. Ky shërbim do të

ofrohet në baza jodiskriminuese dhe do të parandalojë që tarifat shtesë të aplikohen për përdoruesit e rrjetit për kapacitetin që ata tashmë mbajnë. Në veçanti, pagesat për pjesën e kapacitetit të lidhur të kontraktuar që përdoruesit e rrjetit tashmë e konsiderojnë si kapacitet të ndare të pakompensuar do të kufizohen në prim ankandit të mundshëm. Ky shërbim do të bazohet në modelin e konvertimit të hartuar nga ENTSOG. Zbatimi mund të lehtësohet nga platforma / platformat e rezervimit të kapaciteteve të përmendura në Nenin 37. Përdorimi i këtij shërbimi duhet të raportohet çdo vit tek autoritetet përkatëse kombëtare rregullatore.

4. Kur një marrëveshje e lidhjes është rënë dakord ndërmjet përdoruesve përkatës të rrjetit, operatorët e sistemit të transmetimit të përfshirë në pikën e interkonjeksionit duhet të informohen nga palët për një marrëveshje të lidhur të tillë të synuar pa vonesa të panevojshme dhe transferimi i kapacitetit në fjalë do të zbatohet. Sidoqoftë, marrëveshja e lidhjes do të zbatohet në varësi të kushteve të aplikueshme të kontratave ekzistuese të transportit. Pasi të zbatohet marrëveshja e lidhjes, kapaciteti përkatës do të trajtohet si kapacitet lidhur.

5. Sidoqoftë, kohëzgjatja e marrëveshjeve të lidhjes në lidhje me kapacitetin e lidhur sipas ndryshimit të kontratave ekzistuese nuk duhet të tejkalojë kohëzgjatjen e kontratave origjinale të transportit.

6. Të gjitha kapacitetet duhet të lidhen në rastin më të parë. Kontratat ekzistuese të transportit për kapacitetet e ndara nuk mund të rinovohen, zgjaten ose shtyhen pas datës së skadimit të tyre. Një kapaciteti i tillë do të bëhet kapacitet i disponueshëm nga data e skadimit të kontratave të transportit.

## **KREU V**

### **PROCESI I RRRITJES SE KAPACITETIT**

*Neni 22*

#### **Testi ekonomik**

1. Testi ekonomik i përcaktuar në këtë nen do të kryhet nga operatori i sistemit të transmetimit ose nga autoriteti rregullator kombëtar, siç është vendosur nga autoriteti kombëtar rregullator, për secilin nivel të ofertës së një projekti kapaciteti shtesë pasi janë marrë angazhimet e detyrueshme të përdoruesve të rrjetit për kapacitetin kontraktues nga operatorët e sistemit të transmetimit të përfshirë dhe do të përbëhen nga parametrat e mëposhtëm:
  - a) vlera aktuale e angazhimeve të detyrueshme të përdoruesve të rrjetit për kapacitetin kontraktues, e cili llogaritet si shuma e skontuar sipas parametrave të mëposhtëm:
    - (i) shuma e çmimeve të referencës përkatëse të parashikuara dhe një prim i mundshëm e ankandit dhe një premium minimal i detyrueshëm i shumëzuar me vlerën e kapacitetit shtesë të kontraktuar
    - (ii) shuma e një primi të mundshëm të ankandit dhe një minimum primi potencial i detyrueshëm i shumëzuar me shumën e kapacitetit në dispozicion që është kontraktuar në kombinim me kapacitetin në rritje
  - b) vlerën aktuale të rritjes, parashikuar në të ardhurat e lejuara ose të synuara të operatorit të sistemit të transmetimit që shoqërohet me kapacitetin rritës të përfshirë në nivelin përkatës

- të ofertës, të miratuar nga autoriteti përkatës kombëtar rregullator në përputhje me Nenin 28 (2);
- c) faktori-f
2. Rezultati i aplikacionit për testimin ekonomik do të jetë:
- (a) pozitive, kur vlera e parametrut të përcaktuar në paragrafin 1 (a) është të paktën e barabartë me pjesën e parametrut të përcaktuar në paragrafin 1 (b) siç përcaktohet nga faktori-f;
  - (b) negative, ku vlera e parametrut të paraqitur në paragrafin 1 (a) është më e ulët se pjesa e parametrut të përcaktuar në paragrafin 1 (b) siç përcaktohet nga faktori-f.
3. Projekti i kapacitetit rritës do fillojë nëse testi ekonomik ka rezultat pozitiv në të dy anët e pikes së interkonjeksionit për të paktën një nivel oferte që përfshin kapacitetin rritës. Në rastet kur më shumë se një nivel i ofertës ka rezultat pozitiv të testit ekonomik, niveli i ofertës me sasinë më të madhe të kapacitetit që ka rezultuar me një rezultat pozitiv do të përdoret për të vazhduar me projektin e kapacitetit rritës drejt komisionimit. Në rastet kur asnjë nivel i ofertave nuk rezulton me rezultat pozitiv, procesi i rritjes së kapaciteteve specifike do të ndërpritet.

### *Neni 23*

#### **Faktori-F**

1. Gjatë zbatimit të testit ekonomik, përmendur në nenin 22, autoriteti kombëtar rregullator do vendosi nivelin e faktorit -f për një nivel të caktuar të ofertave, duke marrë parasysh si më poshtë:
- (a) Sasia e kapacitetit teknik, vendosur në përputhje me Nenin 8 (8) dhe (9);
  - (b) ekstremitetet pozitive të projektit të kapacitetit rritës në treg ose në rrjetin e transmetimit, ose të dyja;
  - (c) kohëzgjatja e angazhimeve të detyrueshme të përdoruesve të rrjetit për kapacitetin kontraktues në krahasim me jetën ekonomike të asetit;
  - (d) shkalla në të cilën kërkesa për kapacitetin e vendosur në projektin e kapacitetit rritës mund të pritet të vazhdojë pas përfundimit të horizontit kohor të përdorur në testin ekonomik
2. Nëse testi ekonomik ka një rezultat pozitiv, atëherë kostot e investimit në lidhje me kapacitetin rritës do të pasqyrohen në një rritje të të ardhurave të lejuara apo të synuara në përputhje me rregullat kombëtare në fuqi.

### *Neni 24*

#### **Kombinimi në një test të vetëm ekonomik**



1. Për të lehtësuar ofertën e produkteve të kapacitetit të lidhur, parametrat individuale të testimit ekonomik të operatorëve të sistemit të transmetimit të përfshirë për një nivel oferte të caktuar do të kombinohen në një provë të vetme ekonomike.
2. Testi i vetëm ekonomik përbëhet nga parametrat e mëposhtëm:
  - (a) vlera e sotme të angazhimeve të detyrueshme të përdoruesve të rrjetit të përbashkët për kontraktimin e kapacitetit, e cila është shuma e vlerave sipas Nenit 22 (1) (a) të operatorëve të sistemit të transmetimit të përfshirë
  - (b) shuma e vlerave individuale të sotme të rritjes së parashikuar në të ardhurat e lejuara ose të synuara të operatorëve të sistemit të transmetimit të përfshirë që i atribuohet kapacitetit rritës të një niveli përkatës të ofertës
  - (c) faktori-f që përcakton pjesën e parametratit të përcaktuar në pikën (b) që duhet të mbulohet nga parametri i përcaktuar në pikën (a) dhe lejon të gjithë operatorët e përfshirë të sistemit të transmetimit të mbulojnë individualisht pjesët përkatëse të përcaktuara.
3. Rezultati i aplikimit për testimin e vetëm ekonomik është pozitiv, kur të gjitha testet ekonomike themelore ofrojnë rezultate pozitive të përcaktuara në Nenin 22 (2) (a), duke marrë parasysh një rishpërndarje të mundshme të të ardhurave sipas paragrafëve 4 dhe 5. Përndryshe, rezultati i aplikimit të vetëm për testimin ekonomik do jetë negativ.
4. Në rast se një rishpërndarje e të ardhurave potencialisht mund të çojë në një ulje të nivelit të angazhimeve të detyrueshme të përdoruesve të rrjetit për kapacitetin kontraktues të kërkuar për rezultat pozitiv të testit ekonomik, operatorët e sistemit të transmetimit mund të dorëzojnë tek autoritetet përkatëse kombëtare rregullatore për miratimet e koordinuara mekanizmat një rishpërndarje të të ardhurave nga kapaciteti në rritje.
5. Rishpërndarja e të ardhurave mund të kryhet si më poshtë:
  - (a) gjatë procesit të integritetit të parametrave individual të testit ekonomik në një provë të vetme ekonomike;
  - (b) në rast se testi i vetëm ekonomik ofron rezultat negativ ndërsa në të njëjtën kohë niveli i angazhimit të detyrueshëm të përdoruesve të rrjetit për kapacitetin kontraktues tejkalon minimumin e kërkuar për të mbuluar vlerën aktuale individuale të rritjes së të ardhurave të lejuara ose të synuara për të paktën një prej operatorët e sistemit të transmetimit të përfshirë

*Neni 25*

### **Kërkesat e publikimit në lidhje me testin ekonomik**

1. Për një projekt të caktuar të kapacitetit rritës, operatori i sistemit të transmetimit duhet të dorëzojë për miratim tek autoritetet përkatëse kombëtare rregullatore informacionin e mëposhtëm për çdo nivel të ofertës:

- a. çmimet e referencës të vlerësuara për kohëzgjatjen e ofertës fillestare të kapacitetit rritës që përdoren për llogaritjen e parametrave të përcaktuar në Nenin 22 (1) (a) dhe 24 (2) (a), përkatësisht në rast të veçantë ose aplikohet një provë e vetme ekonomike;
  - b. parametrat e përcaktuar në Nenin 22 (1)(b) deri në (c) dhe 24(2)(b) deri (c), respektivisht në rast të veçantë ose kur zbatohet një test i vetëm ekonomik;
  - c. nëse është e aplikueshme, gamën e nivelit të primit minimal të detyrueshëm të referuar në Nenin 33 (4) të Rregullores (BE) 2017/460 për secilën nivel të ofertës dhe pikës së interkonjeksionit të aplikuar në ankandin e parë dhe ndoshta në ankandet e mëvonshme në të cilat rritja e kapacitetit është ofruar siç përcaktohet në Nenin 33 (3) të Rregullores (BE) 2017/460.
2. Pas miratimit nga autoriteti përkatës rregullator kombëtar, informacionet e paraqitura në paragrafin 1 publikohen nga operatori i sistemit të transmetimit të përfshirë siç përcaktohet në Nenin 28 (3).

### *Neni 26*

#### **Vlerësimi i kërkesës së tregut**

1. Menjëherë pas fillimit të ankandit vjetor të kapacitetit, të paktën në çdo vit me numër tek, operatorët e sistemit të transmetimit bashkëpunojnë në proceset e vlerësimit të kërkesës së tregut për kapacitet në rritje dhe kryerjes së studimeve teknike për projekte të kapaciteteve në rritje për pikat e tyre të përbashkëta të interkonjeksionit. Vlerësimi i parë i kërkesës do të bëhet në vitin 2021.
2. Jo më vonë se 8 javë pas fillimit të ankandit vjetor të kapacitetit, të paktën në çdo vit me numër tek, operatorët përkatës të sistemit të transmetimit në secilën anë të kufirit të sistemit hyrje-dalje do të prodhojnë raporte të vlerësimit të kërkesës së tregut të përbashkët, secila që mbulon të gjitha pikat e interkonjeksionit e së paku një kufiri të sistemit hyrje-dalje. Raporti i vlerësimit të tregut do të vlerësojë kërkesën e ardhshme për kapacitet në rritje të të gjithë përdoruesve të rrjetit në përputhje me paragrafin 8 dhe do të përcaktojë nëse do të fillohet një projekt për rritje të kapacitetit.
3. Raporti i vlerësimit të kërkesës së tregut do të publikohet në një ose më shumë gjuhë zyrtare të Palës Kontraktore dhe mundësisht në anglisht në faqet e internetit të operatorëve të sistemit të transmetimit, jo më vonë se 16 javë pas fillimit të ankandit vjetor të kapacitetit të paktën në çdo vit tek.
4. Operatorët e sistemit të transmetimit, duhet të plotësojnë raportet e vlerësimit të kërkesës bazuar në modelin standard të hartuar nga ENTSOG dhe të publikojnë raportet në faqen e tyre të internetit.
5. Nëse kërkesa për kapacitet rritës shprehet nga përdoruesit e rrjetit jo më vonë se 8 javë pas fillimit të ankandit vjetor në vite me numër çift, operatorët përkatës të sistemit të transmetimit mund të bien dakord që të bëjnë vlerësimin e kërkesës së tregut gjithashtu në një vit me numër çift, me kusht që:
  - a. procesi i përcaktuar në Nenet 26-30 mund të përfundojë para fillimit të ciklit të ardhshëm të vlerësimit të kërkesave të përmendur në paragrafin 1; dhe

- b. kalendari i ankandit është respektuar.
6. Operatorët e sistemit të transmetimit do të marrin parasysh indikacionet jo të detyrueshme të kërkesave të dorëzuara jo më vonë se 8 javë pas fillimit të ankandit vjetor në vlerësimin e vazhdueshëm të kërkesës së tregut.
  7. Operatorët e sistemit të transmetimit mund të marrin parasysh indikacionet jo të detyrueshme të kërkesave të dorëzuara pas afatit të përcaktuar në paragrafin 6 në vlerësimin e kërkesës së tregut në vijim, ose t'i përfshijnë ato në vlerësimin e ardhshëm të kërkesës së tregut.
  8. Treguesit e kërkesës jo të detyrueshme të referuara në paragrafët 6 dhe 7 duhet të përmbajnë së paku informacionin e mëposhtëm:
    - a. dy ose më shumë sisteme të hyrjes-daljeve fqinje midis të cilave shprehet kërkesa për kapacitet rritës - në një ose të dy anët e një pike interkonjeksioni dhe drejtimi i kërkuar;
    - b. vitet e gazit për të cilin shprehet një kërkesë për kapacitet rritës;
    - c. sasia e kapacitetit të kërkuar midis sistemeve përkatëse hyrëse-dalëse;
    - d. informacion mbi indikacionet jo të detyrueshme të kërkesave të cilat janë apo do t'u dorëzohen operatorëve të tjerë të sistemit të transmetimit, në rast se indikacionet e tilla janë të lidhura me njëra-tjetrën, siç është kërkesa për kapacitete në disa pika të interkonjeksionit;
  9. Përdoruesit e rrjetit duhet të tregojnë nëse kërkesa e tyre i nënshtrohet ndonjë kushti në lidhje me pikat (a) deri (d) të paragrafit 8.
  10. Operatorët e sistemit të transmetimit i përgjigjen indikacioneve jo të detyrueshme të kërkesës brenda 16 javëve pas fillimit të ankandeve vjetore ose brenda 8 javëve nga marrja e indikacioneve të kërkesës në përputhje me paragrafin 7. Përgjigja duhet të sigurojë të paktën sa më poshtë:
    - a. nëse kërkesa e treguar mund të konsiderohet nga operatori i sistemit të transmetimit në procesin në vazhdim; ose
    - b. nëse, në rastin e indikacioneve të kërkesës në përputhje me paragrafin 7, ato janë të mjaftueshme për të konsideruar fillimin e një procesi kapaciteti rritës sipas paragrafit 5; ose
    - c. në të cilën raporti i vlerësimit të kërkesës së tregut, sipas paragrafit 3, kërkesa e treguar do të vlerësohet, me kusht që kërkesa e treguar nuk mund të konsiderohet sipas pikës (a) ose (b), e cila duhet të justifikohet.
  11. Një operator i sistemit të transmetimit mund të ngarkojë tarifa për aktivitetet që rezultojnë nga paraqitja e indikacioneve jo të detyrueshme të kërkesës. Këto tarifa do të pasqyrojnë kostot administrative për paraqitjen e indikacioneve të kërkesës dhe do të jenë subjekt i miratimit nga autoriteti përkatës kombëtar rregullator dhe të publikohen në faqen e internetit të operatorit të sistemit të transmetimit. Tarifat e tilla do të rimbursohen tek përdoruesi përkatës i rrjetit nëse testi ekonomik për të paktën një nivel oferte që përfshin kapacitetin rritës në pikën përkatëse të interkonjeksionit është pozitive.
  12. Raporti i vlerësimit të kërkesës së tregut duhet të marrë parasysh të gjitha kriteret e mëposhtme:

- a. nëse plani 10-vjeçar i zhvillimit të rrjetit, aty ku është e aplikueshme, identifikon hendekun fizik të kapaciteteve ku një rajon i veçantë nuk është i siguar në një skenar të arsyeshëm të pikut dhe kur ofrimi i kapacitetit rritës në pikën e interkonjeksionit në fjalë mund të mbyllë hendekun; ose një plan zhvillimor i rrjetit kombëtar identifikon një kërkesë konkrete dhe të qëndrueshme të transportit fizik
- b. nëse asnjë produkt vjetor i kapaciteteve standarde që lidh dy sisteme të hyrjes-daljes fqinje nuk është në dispozicion në ankandin vjetor të kapacitetit vjetor për vitin në të cilin kapaciteti rritës mund të ofrohet për herë të parë dhe në 3 vitet pasuese, sepse të gjitha kapacitetet janë kontraktuar;
- c. nëse përdoruesit e rrjetit kanë paraqitur indikacione jo-detyruese të kërkesës që kërkojnë kapacitet rritës për një numër të qëndrueshëm vjetësh dhe të gjitha mjetet e tjera efikase ekonomike për të maksimizuar disponueshmërinë e kapacitetit ekzistues janë harxhuar.

13. Raporti i vlerësimit të kërkesës së tregut duhet të përfshijë të paktën sa më poshtë:

- a. një konkluzion nëse do të iniciojë një projekt kapaciteti në rritje;
- b. indikacionet agregate të kërkesave jo të detyrueshme të pranuar jo më vonë se 8 javë pas fillimit të ankandit vjetor të kapacitetit vjetor në vitin e publikimit të raportit përkatës të vlerësimit të kërkesës;
- c. indikacionet e agreguara të kërkesës jo të detyrueshme të dorëzuara pas afatit të përmendur në paragrafin 6 gjatë procesit të mëparshëm të kapacitetit rritës në rast se këto indikacione të kërkesës nuk janë marrë në konsideratë për vlerësimin e kërkesës së mëparshme;
- d. indikacionet e agreguara të kërkesave jo të detyrueshme të paraqitura në përputhje me paragrafin 7, kur operatorët e sistemit të transmetimit kanë vendosur të marrin në konsideratë ato në vlerësimin e vazhdueshëm të kërkesës së tregut;
- e. një vlerësim të sasisë së pritshme, drejtimin dhe kohëzgjatjen e kërkesës për kapacitet në rritje në pikat e interkonjeksionit me çdo sistem të hyrjes-daljes fqinje ose interkonektive;
- f. një përfundim nëse do të kryhen studime teknike për projektet e kapaciteteve në rritje, duke specifikuar për cilat pika të interkonjeksionit dhe për çfarë niveli të pritshëm të kërkesës;
- g. afatet e përkohshme për projektin e kapacitetit rritës, studimet teknike dhe konsultimet e përmendura në Nenin 27 (3);
- h. një konkluzion mbi çfarë tarifash, nëse ka, do të futet, sipas paragrafit 10;
- i. llojet dhe, kur është e mundur, madhësinë e agreguar të treguesve të kërkesës së kushtëzuar sipas paragrafit 9;
- j. si operatorët e sistemit të transmetimit synojnë të aplikojnë Nenin 11 (3) në lidhje me kufizimin e numrit të viteve që ofrohen në ankandet vjetore të kapacitetit vjetor gjatë procesit rritës.

14. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe autoritetet relevante kombëtare rregullatore do të publikojnë pikat përkatëse të kontaktit për projektet e kapaciteteve në rritje të iniciuara në publikimin e raportit të vlerësimit të kërkesës së tregut dhe të perditesojnë këtë informacion në mënyrë të rregullt gjatë gjithë projektit.

#### *Neni 27*

### **Faza e projektimit**

1. Një ditë pas publikimit të raportit të vlerësimit të kërkesës së tregut, faza e projektimit do të fillojë, nëse raporti i vlerësimit të kërkesës identifikon kërkesën për projekte në rritje të kapaciteteve.
2. Operatorët e sistemit të transmetimit që veprojnë në pikën përkatëse të interkonjeksionit duhet të kryejnë studime teknike për projektet e kapaciteteve në rritje me qëllim të projektimit të projektit të kapacitetit rritës dhe niveleve të ofertës së koordinuar bazuar në fizibilitetin teknik dhe raportet e vlerësimit të kërkesës së tregut.
3. Jo më vonë se 12 javë pas fillimit të fazës së projektimit, operatorët përkatës të sistemit të transmetimit do të kryejnë një konsultim të përbashkët publik mbi projekt propozimin në një ose më shumë gjuhë zyrtare të Palës Kontraktore dhe për aq sa është e mundur në gjuhën angleze për një minimum prej 1 muaj dhe jo më shumë se 2 muaj. Këta operatorë duhet të marrin të gjitha hapat e arsyeshëm për të siguruar koordinimin ndërkuftar. Konsultimi duhet të përfshijë të paktën elementët e mëposhtëm:
  - a. një përshkrim të projektit të kapacitetit rritës, duke përfshirë një vlerësim të kostos;
  - b. nivelet e ofertës për produktet e kapacitetit të lidhur në pikën e interkonjeksionit;
  - c. ku është e përshtatshme, bazuar në indikacionet e kërkesës së kushtëzuar të pranuar, mekanizmi alternativ i propozuar nga operatorët e sistemit të transmetimit duke përfshirë arsyetimin e tij;
  - d. afatet e përkohshme të projektit të kapacitetit rritës;
  - e. rregullat dhe kushtet e përgjithshme që përdoruesit e rrjetit duhet të pranojnë për të marrë pjesë dhe të kenë akses në ofertimin e kapacitetit në fazën e alokimit të procesit të kapacitetit rritës, duke përfshirë çdo kolateral që do të ofrohet nga përdoruesit e rrjetit dhe si vonesat e mundshme në sigurimin e kapacitetit ose rast të prishjes së projektit trajtohen në mënyrë kontraktuale;
  - f. ku ndiqet një qasje e çmimeve fikse për projektin e kapacitetit rritës, elementet IND dhe RP përshkruar në Nenin 24 (b) të Rregullores (BE) 2017/460.
  - g. niveli i angazhimeve të përdoruesit, i shprehur si një vlerësim i faktorit f siç zbatohet në përputhje me Nenin 23, i cili pas konsultimit me operatorët e sistemit të transmetimit, propozohet dhe miratohet më pas nga autoritetet përkatëse kombëtare rregullatore;
  - h. çdo tregues shtesë të kërkesës të marrë në përputhje me Nenin 26 (7);

- i. nëse kapaciteti rritës ka të ngjarë të rezultojë në një rënie të qëndrueshme dhe të konsiderueshme të shfrytëzimit të infrastrukturës tjetër jo të amortizuar të gazit në sistemet e njëjta dhe të afërta hyrëse-dalëse ose përgjatë së njëjtës rrugë të transportit të gazit.
4. Në procesin e hartimit të niveleve të ofertës së koordinuar, operatorët e sistemit të transmetimit bashkëpunojnë ngushtë me autoritetet rregullatore kombëtare të përfshira dhe koordinojnë kufijtë në mënyrë që të mundësojnë oferta të kapacitetit rritës si produkte të lidhura (bundled). Propozimi i projektit dhe dizenjimi i niveleve të ofertës së koordinuar duhet të marrin parasysh rezultatet e konsultimit të parashikuara në paragrafin 3.

### *Neni 28*

#### **Miratimi dhe publikimi**

1. Pas konsultimit dhe finalizimit të fazës së projektimit për një projekt të kapaciteteve në rritje në përputhje me Nenin 27, operatorët e sistemit të transmetimit duhet të dorëzojnë projekt propozimin për një projekt të kapacitetit rritës tek autoritetet përkatëse kombëtare rregullatore për miratimet e koordinuara. Propozimi i projektit gjithashtu do të publikohet nga operatorët e sistemit të transmetimit të përfshirë në një ose më shumë gjuhë zyrtare të Palës Kontraktore dhe mundësisht në gjuhën angleze dhe duhet të përfshijë së paku informacionin e mëposhtëm:
  - a. të gjitha nivelet e ofertës, duke reflektuar gamën e kërkesës së pritur për kapacitet në rritje në pikat përkatëse të interkonjeksionit si rezultat i proceseve të parashikuara në paragrafin 3 të Nenit 27 dhe Nenit 26;
  - b. rregullat dhe kushtet e përgjithshme që një përdorues i rrjetit duhet të pranojë për të marrë pjesë dhe të ketë akses në kapacitet në fazën e ndarjes së kapacitetit procesin e kapacitetit rritës, duke përfshirë çdo kolateral që do të ofrohet nga përdoruesit e rrjetit dhe si vonesat e mundshme në sigurimin e kapacitetit ose ngjarja e ndërprerjes të projektit trajtohen me kontratë;
  - c. afatet kohore të projektit të kapacitetit rritës, përfshirë çdo ndryshim që nga konsultimi i përshkruar në paragrafin 3 të Nenit 27 dhe masat për të parandaluar vonesat dhe minimizuar ndikimin e vonesave;
  - d. parametrat e përcaktuar në Nenin 22 (1);
  - e. nëse mund të kërkohet një afat kohor jashtëzakonisht i zgjatur për kapacitetin kontraktues për një periudhë shtesë deri në 5 vjet përtej ndarjes deri në 15 vjet pas fillimit të përdorimit operacional, në përputhje me Nenin 30;
  - f. ku është e aplikueshme, mekanizmin e propozuar alternativ të alokimit duke përfshirë një arsyetim të tij në pajtim me Nenin 30 (2) si dhe kushtet e miratuara nga operatori i sistemit të transmetimit për fazën detyruese në pajtim me Nenin 30 (3);
  - g. ku ndjek një qasje të çmimit fiks për projektin e kapacitetit rritës, elementet e përshkruara në Nenin 24 (b) të Rregullores (BE) 2017/460
2. Brenda 6 muajve nga marrja e propozimit të plotë të projektit nga autoritetet relevante rregullatore, autoritetet kombëtare rregullatore do të botojnë vendimet e koordinuara mbi

propozimin e projektit të përcaktuar në paragrafin 1 në një ose më shumë gjuhë zyrtare të Palës Kontraktore dhe mundësisht në Anglisht. Vendimet duhet të përfshijnë arsyetime. Autoritetet kombëtare rregullatore do të informojnë njëra-tjetrën për pranimin e propozimit të projektit dhe plotësimin e tij me qëllim të përcaktimit të fillimit të periudhës 6 mujore.

Gjatë përgatitjes së vendimit të autoritetit rregullator kombëtar, çdo autoritet kombëtar rregullator do të marrë parasysh pikëpamjet e autoriteteve të tjera rregullatore kombëtare të përfshira. Në çdo rast, autoritetet kombëtare rregullatore do të marrin parasysh çdo efekt dëmtes mbi konkurrencën ose funksionimin efektiv të tregut të brendshëm të gazit që shoqërohet me projektet e kapaciteteve shtesë në fjalë.

Nëse një autoritet kombëtar rregullator kundërshton propozimin e projektit të paraqitur, ai duhet të informojë autoritetet e tjera rregullatore kombëtare të përfshira sa më shpejt që të jetë e mundur. Në një situatë të tillë, të gjitha autoritetet kombëtare rregullatore të përfshira do të ndërmarrin të gjitha hapat e arsyeshëm për të punuar së bashku dhe për të arritur një marrëveshje të përbashkët.

Kur autoritetet rregullatore kombëtare relevante nuk mund të arrijnë një marrëveshje mbi mekanizmin e propozuar alternativ të alokimit brenda periudhës 6 mujore të përmendur në nënparagrafin e parë, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do të vendosë mbi mekanizmin alternativ të alokimit që do të zbatohet, duke ndjekur procesin e përcaktuar në Neni 6 (2a) të kësaj Rregulloreje.

3. Me publikimin e vendimeve të autoriteteve rregullatore kombëtare në përputhje me paragrafin 2 dhe jo më vonë se dy muaj përpara ofertës së kapacitetit rritës në ankandin vjetor të kapacitetit vjetor, operatorët e sistemit të transmetimit publikojnë së bashku një njoftim në një ose më shumë gjuhë zyrtare të Palës Kontraktore dhe mundësisht në gjuhën angleze duke përfshirë informacionin e mëposhtëm minimal:
  - a. informacioni i përcaktuar në paragrafin 1 të miratuar nga autoritetet rregullatore kombëtare;
  - b. një format i kontratës në lidhje me kapacitetin e ofruar.

#### *Neni 29*

### **Hedhja ne ankand i kapacitetit rritës**

1. Në varësi të përfundimit të hapave të parashikuara në Nenin 27, operatorët e përfshirë të sistemit të transmetimit duhet të ofrojnë kapacitetin rritës së bashku me kapacitetin përkatës në dispozicion në ankandin vjetor të kapacitetit, si produkte standarte të lidhura në ankandet e cmimit në rritje sipas Nenit 17 si standart dhe në përputhje me Nenin 8 (8) dhe (9) dhe Nenin 19.

2. Ankandet për nivelet përkatëse të ofertave kryhen paralelisht dhe në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra në përputhje me Nenin 17 dhe në pajtim me Nenin 8 (2). Vetëm nivelet e ofertës së koordinuar do të hidhen ne ankand.
3. Për të minimizuar primin potencial të ankandit dhe për të arritur një rezultat pozitiv të testit ekonomik për nivelin më të lartë të mundshëm të ofertës, një ankand i ri mund të fillohet një herë dhe vetëm nëse:
  - a. ka pasur të paktën dy nivele të ofertave të vendosura nga operatorët e sistemit të transmetimit para fillimit të ankandëve të përshkruara në paragrafin 2; dhe
  - b. të paktën një nivel i ofertës ishte i pasuksesshëm dhe rezultoi në një test ekonomik negativ; dhe
  - c. niveli tjetër i ofertës më të vogël i ofertës më të ulët të pasuksesshme rezulton në një test pozitiv ekonomik dhe u ekuilibrua me një prim ankandi për të paktën një produkt të kapacitetit standard vjetor.

Nëse këto kushte janë plotësuar, ankandi i ri mund të iniciohet për nivelin më të ulët të ofertës së pasuksesshme të referuar në pikën (b).

4. Nëse ankandi i ri nuk rezulton me një rezultat pozitiv të testit ekonomik, rezultatet e alokimit të ankandit origjinal të përmendur në pikën (c) do të mbizotërojnë në përputhje me nenet 17 (20) dhe (21).

### *Neni 30*

#### **Parimet për mekanizmat e alternative te alokimit**

1. Një mekanizëm alternativ i alokimit mbulon një maksimum prej 15 vjetësh pas fillimit të përdorimit operacional. Nëse testi ekonomik nuk mund të miratohet në bazë të rezervimeve prej 15 vjetësh, autoritetet kombëtare rregullatore mund të zgjasin në mënyrë të veçantë kohëzgjatjen deri në 5 vjet shtesë.
2. Mund të përdoret një mekanizëm alternativ i alokimit të kapaciteteve, në varësi të miratimit të autoriteteve kombëtare rregullatore, kur është e arsyeshme të përfundohet nga vlerësimi i kërkesës së tregut në pajtim me Nenin 26 ose konsultimi i përcaktuar në Nenin 27 (3), që ankandi i cmimit ne rritje nuk është i përshtatshëm dhe se projekti i kapacitetit rritës plotëson të dyja këto kushte:
  - a. përfshin më shumë se dy sisteme hyrëse-dalëse dhe kërkohet oferta përgjatë disa pikave të interkonjeksionit gjatë procedurës së alokimit;
  - b. kërkohen oferta me kohëzgjatje më shumë se një vit;
3. Në një mekanizëm alternativ të alokimit përdoruesit e rrjetit mund të paraqesin oferta të detyrueshme të kushtëzuara për kapacitetin kontraktues, subjekt i një ose më shumë kushteve të mëposhtme të përcaktuara nga operatorët e sistemit të transmetimit në propozimin e miratuar të projektit, në përputhje me Nenin 28 (1):



- a. angazhimet që lidhin ose përjashtojnë angazhimet në pikat e tjera të interkonjeksionit;
  - b. angazhimet në një numër të produkteve të ndryshme vjetore të kapacitetit standard në një pikë interkonjeksioni;
  - c. angazhimet e kushtëzuara me alokimin e një sasi të caktuar ose minimale të kapacitetit.
4. Mekanizmi alternativ i alokimit i nënshtrohet miratimit nga autoritetet përkatëse kombëtare rregullatore sipas Nenit 28 (2). Mekanizmi duhet të jetë transparent dhe jo-diskriminues, por mund të lejojë përcaktimin e prioritetit të kohëzgjatjes së rezervimit ose ofertat për sasi më të larta të kapacitetit për një produkt vjetor të kapacitetit standard.
  5. Nëse afatet e rezervimit ose të ofertave për sasi më të larta të kapacitetit janë prioritet, autoritetet kombëtare rregullatore vendosin të lënë mënjane një shumë prej të paktën 10% dhe deri në 20% të kapacitetit teknik në secilën pikë të interkonjeksionit, kur zbaton Nenin 8 (8). Kapaciteti i caktuar në këtë mënyrë do të ofrohet në përputhje me Nenin 8 (7).

#### *Neni 31*

### **Rregullimet tranzitore**

Në rastin e projekteve të kapaciteteve në rritje të iniciuara përpara skadimit të afatit për transpozimin e kësaj rregulloreje, do të zbatohen nenet 26 deri në 30, përveç nëse projekteve të tilla janë dhënë miratimet e aplikueshme për alokimin e kapaciteteve nga autoritetet përkatëse kombëtare rregullatore para [4 muaj pas skadimit e afatit për transpozim].

## **KREU VI KAPACITETI I NDERPRERE**

#### *Neni 32*

### **Alokimi i shërbimeve të ndërprera**

1. Që nga [9 muaj pas mbarimit të afatit të transpozimit], operatorët e sistemit të transmetimit mund të ofrojnë vetëm produkte të kapacitetit standard për kapacitete të ndërprere me një kohëzgjatje më të gjatë se një ditë nëse produkti i kapacitetit të standardit mujor, tremujor ose vjetor për kapacitetin e garantuar është shitur në një çmim ankandi, ishte ezauruar ose nuk ishte ofruar.
2. Operatorët e sistemit të transmetimit do të ofrojnë një produkt të kapacitetit ditor për kapacitetin e ndërprere në të dy drejtimet në pikat e interkonjeksionit ku produkti përkatës i kapacitetit standard për kapacitetin e garantuar ishte ezauruar ditën në avance ose nuk ishte ofruar. Në pikat e interkonjeksionit me një drejtim ku kapaciteti i garantuar ofrohet vetëm në një drejtim, operatorët e sistemit të transmetimit duhet të ofrojnë së paku një produkt ditor për kapacitetin e ndërprerë në drejtimin tjetër.
3. Nëse ofrohet kapaciteti i ndërprere, ai nuk do të cenojë sasinë e kapacitetit të garantuar në ofertë. Operatorët e sistemit të transmetimit nuk do të lënë mënjane kapacitetet që mund të ofrohen si kapaciteti i garantuar për ta ofruar atë si kapacitet të ndërprerë.

4. Në masën që ofrohen produkte të kapacitetit të ndërprere, përveç produkteve ditore, të njëjtat produkte të kapacitetit standard për kapacitetin e garantuar do të aplikohen gjithashtu për kapacitetin e ndërprerë, në lidhje me kohëzgjatjen e produkteve.
5. Në masën që ofrohet kapaciteti i ndërprerë, ai do të ndahet nëpërmjet një procesi ankandi me përjashtim të kapacitetit të ndërprerë brenda ditës.
6. Kapaciteti i ndërprere brenda ditës do të ndahet me anë të një procedure mbi-nominim.
7. Kapaciteti i ndërprere brenda ditës alokohet vetëm kur kapaciteti i garantuar, qoftë kapacitet teknik ose kapacitet shtesë, është shitur.
8. Kur ankandet për çdo produkt të ndërprerë më të gjatë se brenda ditës, operatorët e sistemit të transmetimit, nëse njihen, publikojnë sasitë e kapacitetit të ndërprere që ofrohet përpara fillimit të procesit të ankandit.
9. Nëse ofrohet, kapaciteti i ndërprere do të ndahet me anë të një ankandi të veçantë pasi të jetë alokuar kapaciteti i garantuar me kohëzgjatje të barabartë, por para se të fillojë ankandi i kapacitetit të garantuar me një kohëzgjatje më të shkurtër, me përjashtim të kapacitetit të ndërprerë brenda ditës.
10. Nëse ofrohen, ankandet e kapacitetit të ndërprere duhet të kryhen në përputhje me parimet e njëjta të projektimit dhe afatet kohore që aplikohen për kapacitetin e garantuar. Datat e sakta të ankandit që do të përdoren për ankandet e kapacitetit të ndërprere duhet të detajohen brenda kalendarit të ankandit me përjashtim të kapacitetit të ndërprerë brenda ditës. Për çdo vit vjetor, të gjitha ankandet tremujore vjetore dhe gjithsej të linjës mujore të kapacitetit, operatorët e sistemit të transmetimit duhet të njoftojnë përdoruesit e rrjetit për sasinë e kapacitetit të ndërprerë që do të ofrohet një javë para fillimit të ankandit. Kur ankandi i kapacitetit të garantuar nuk është mbyllur në ditën e planifikuar të fillimit për ankandet e kapacitetit të ndërprere, ankandet e kapacitetit të ndërprere duhet të celen jo më vonë se ditën tjetër të punës pas mbylljes së ankandeve përkatëse të kapacitetit të garantuar. Në raste të tilla, çdo ndryshim në shumat e ofruara do të njoftohet së paku 12 orë para fillimit të ankandit përkatës të kapacitetit të ndërprere.

### *Neni 33*

#### **Kohët minimale të ndërprerjeve**

1. Kapacitetet e ndërprera do të kenë afat minimale të ndërprerjeve, të cilat do të vendosen bashkërisht nga operatorët e sistemit të transmetimit fqinje.
2. Kohëzgjatja minimale e ndërprerjes për një orë të caktuar të gazit duhet të jetë 45 minuta pas fillimit të ciklit të rinominimit për atë orë të gazit. Kur dy operatorët e sistemit të transmetimit dëshirojnë të shkurtojnë kohën e kalimit për ndërprerje, çdo marrëveshje e lidhur ndërmjet operatorëve të sistemit të transmetimit i nënshtrohet miratimit të autoritetit kombëtar kompetent rregullator.

### *Neni 34*

#### **Koordinimi i procesit të ndërprerjes**

Operatori i sistemit të transmetimit që fillon ndërprerjen, duhet të njoftojë operatorin përkatës të sistemit të transmetimit. Operatorët e sistemit të transmetimit fqinje duhet të njoftojnë përdoruesit

e rrjetit të tyre përkatës sa më shpejt që të jetë e mundur, por duke pasur parasysh besueshmërinë e informacionit.

#### *Neni 35*

### **Sekuena e përcaktuar e ndërprerjeve**

1. Urdhri në të cilin do të kryhen ndërprerjet, nëse shuma e nominimeve tejkalon sasinë e gazit që mund të rrjedhë në një pikë të caktuar interkonjeksioni, do të përcaktohet në bazë të vullës kohore kontraktuale të kontratave respektive të transportit në bazë të ndërprerjes. Në rast të një ndërprerje, kontrata e transportit që hyn në fuqi më herët do të prevalojë mbi kontratën e transportit që hyn në fuqi më vonë.
2. Nëse, pas zbatimit të procedurës të parashikuar në paragrafin 1, dy ose më shumë nominimet të cilat janë renditur në të njëjtin pozicion brenda urdhrit të ndërprerjes dhe operatori i sistemit të transmetimit nuk i ndërpret të gjitha ato, zbatohet një reduktim proporcional i këtyre nominimeve specifike.
3. Për të akomoduar dallimet ndërmjet shërbimeve të ndryshme të kapacitetit të ndërprerjes brenda Komunitetit të Energjisë, operatorët e sistemit të transmetimit fqinje duhet të zbatojnë dhe bashkërendojnë procedurat e përbashkëta të parashikuara në këtë nen në një pikë interkonjeksioni me bazë pikat e interkonjeksionit

#### *Neni 36*

### **Arsyet për ndërprerje**

Operatorët e sistemit të transmetimit duhet të përfshijnë arsyet e ndërprerjeve qoftë drejtpërdrejt në kontratat e tyre të ndërprerjes së transportit ose në termat dhe kushtet e përgjithshme që rregullojnë këto kontrata. Arsyet për ndërprerje mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në cilësinë e gazit, presionin, temperaturën, modelet e rrjedhjes, përdorimin e kontratave të garantuara, mirëmbajtjen, kufizimet në *upstream* apo *downstream*, detyrimet e shërbimit publik dhe menaxhimin e kapaciteteve që rrjedhin nga procedurat e menaxhimit të konxhestionit.

## **KREU VII**

### **PLATFORMA E REZERVIMIT TE KAPACITETEVE**

#### *Neni 37*

### **Platforma për rezervimin e kapaciteteve**

1. Operatorët e sistemit të transmetimit do zbatojnë këtë Rregullore duke ofruar kapacitete me anë të një numri të kufizuar të platformave të përbashkëta të rezervimit online. Operatorët e sistemit të transmetimit mund të përdorin platforma të tilla vetë ose nëpërmjet një pale të dakorduar që, kur është e nevojshme, vepron në emër të tyre drejt përdoruesve të rrjetit.

2. Platforma e përbashkët e rezervimit duhet të zbatohet rregullat e mëposhtme:
  - (a) do të zbatohen rregullat dhe procedurat për ofertën dhe alokimin e të gjithë kapaciteteve në përputhje me Kreun III;
  - (b) do të ketë prioritet krijimi i një procesi për të ofruar kapacitet të lidhur në mënyrë të garantuar në përputhje me Kreun IV;
  - (c) do të sigurohen funksionalitetet për përdoruesit e rrjetit për të ofruar dhe marrë kapacitete sekondare;
  - (d) Për shfrytëzimin e shërbimeve të përdoruesve të rrjetit të platformave të rezervimit, përdoruesit duhet të aderojnë në dhe të jenë në përputhje me të gjitha kërkesat e aplikueshme ligjore dhe kontraktuale, të cilat u mundësojnë atyre të kontabilizojnë dhe shfrytëzojnë kapacitetin në rrjetin përkatës të operatorëve të sistemit të transmetimit sipas kontratës së transportit;
  - (e) kapaciteti në çdo pikë interkonjeksioni ose pikë virtuale interkonektive do të ofrohet në jo më shumë se një platformë rezervimi, por një operator i sistemit të transmetimit mund të ofrojë kapacitete në pikat e interkonjeksionit të ndryshëm ose virtual të interkonjeksionit përmes platformave të ndryshme të rezervimit.
3. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi i afatit për transpozimin e kësaj rregulloreje, të gjithë operatorët e sistemit të transmetimit duhet të arrijnë një marrëveshje kontraktuale për të përdorur një platformë të vetme rezervimi për të ofruar kapacitet në të dy anët e pikave përkatëse të interkonjeksionit ose pikave virtuale të interkonjeksionit. Nëse nuk arrihet marrëveshje nga operatorët e sistemit të transmetimit brenda asaj periudhe, çështja i referohet menjëherë operatorëve të sistemit të transmetimit tek autoritetet përkatëse kombëtare rregullatore. Autoritetet kombëtare rregullatore më pas, brenda një afati 6 muajor nga data e kërkesës, së bashku zgjedhin platformën e vetme të rezervimit për një periudhë jo më të gjatë se 3 vjet. Nëse autoritetet rregullatore kombëtare nuk janë në gjendje të zgjedhin së bashku një platformë të vetme rezervimi brenda 6 muajve nga data e referimit, zbatohet Neni (2a) i kësaj rregulloreje. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do të vendosë për platformën e rezervimit për t'u përdorur, për një periudhë jo më të gjatë se 3 vjet, në pikën specifike të interkonjeksionit ose pikën virtuale të interkonjeksionit.
4. Në rast se përzgjedhja e platformës së rezervimit në një pikë interkonjeksioni ose pikë virtuale interkonektive është bërë nga autoritetet kombëtare rregullatore ose nga Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë, operatorët e sistemit të transmetimit duhet të arrijnë një marrëveshje kontraktuale mbi përdorimin e një platforme rezervimi jo më vonë se periudha e përmendur në fjalinë e fundit të paragrafit 3, për të cilën përzgjedhja është bërë nga autoritetet kombëtare rregullatore ose Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë. Nëse nuk arrihet një marrëveshje kontraktuale, procedura e paraqitur në paragrafin 3 do të rifillojë.
5. Krijimi i një platforme ose i një numri të kufizuar të platformave të përbashkëta rezervimi do të lehtësojë dhe thjeshtëzojë rezervimin e kapaciteteve në pikat e interkonjeksionit në Komunitetin e Energjisë për benefitet e përdoruesve të rrjetit.
6. Për rritjen e kapacitetit teknik, rezultatet e alokimit do të publikohen në platformën e rezervimit e cila përdoret për ankandin e kapacitetit ekzistues dhe për kapacitetin e ri të krijuar aty ku

aktualisht nuk ekziston, në një platformë të përbashkët të rezervimit të dakorduar nga operatorët përkatës të sistemit të transmetimit.

## **KREU VIII**

### **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

*Neni 38*

#### **Monitorimi i zbatimit**

Në kontekst të zbatimit të përgjegjësiave të monitorimit të zbatimit, Sekretariati do të monitorojë dhe analizojë se si operatorët e sistemit të transmetimit kanë zbatuar këtë Rregullore 2. Operatorët e sistemit të transmetimit duhet t'i dorëzojnë Sekretariatit të gjitha informacionet e kërkuara nga Sekretariati për të përmbushur detyrimet e tij sipas paragrafit 1, jo më vonë se [9 muaj] pas skadimit të afatit për transpozimin e kësaj Rregulloreje 3. Konfidencialiteti i informacionit komercialisht të ndjeshëm ruhet nga Sekretariati 4. Jo më vonë se dy vjet pas skadimit të afatit për transpozimin e kësaj rregulloreje, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do të raportojë mbi kushtet e parashikuara në kontratat për produkte të kapacitetit standard për kapacitetin e garantuar, duke pasur parasysh efektet e tyre në përdorimin efikas të rrjetit dhe integrimin e tregjeve të gazit të Komunitetit të Energjisë. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë do të mbështetet në vlerësimin e tij nga autoritetet kombëtare rregullatore dhe operatorët e sistemit të transmetimit.

*[Për vendim nga GPNL]*

1. *Deri në [9] muaj nga data e miratimit, çdo Palë Kontraktore do të transpozojë Rregulloren (BE) Nr 2017/460, të përshtatur me këtë Vendim.*
2. *Ky Vendim do të bëhet i detyrueshëm për të gjithë pjesëmarrësit e tregut. Transpozimi do të behet pa ndryshime në strukturën e tekstit të Rregullores (EU) Nr 2017/460 prevec perkthimit dhe pershtatjes të bere sipas ketij vendimi..*
3. *Pa paragjykim të Nenit 11(4), 19(9), 26(1), 31, 32 dhe 37(3) cdo Pale Kontraktore do të zbatojë Rregulloren (EU) Nr 2017/460 sic është përshtatur me këtë Vendim, deri në [15] muaj nga data e miratimit.*
4. *Çdo Palë Kontraktore do të njoftojë Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për transpozimin e plotësuar brenda dy javësh pas miratimit të këtyre masave.*
5. *Në transpozimin e këtij vendimi, Palët Kontraktore do t'i kryejnë autoritetet rregullatore kombëtare monitorimin dhe zbatimin e pajtueshmërisë me këtë Vendim.*